

Mësuesi



Cilësi në arsim

Botim i përdyjavshëm i MASH nr. **10** (2556) - nëntor 2010



TRADITË & KULTURË



MËSUESI & NXËNËSI



ARSIMI & REFORMA



SHKOLLA & KOMUNITETI

Me lëvizjen e lirë këtë dhjetor,
Rinis epoka evropiane për Shqipërinë

Tek nxënësit dhe studentët tanë qëndron
Epoka shqiptare për Evropën

Ministri Tafaj, i ftuar nderi në Ditën Akademike të Universitetit Otto-Friedrich të Bambergut, Gjermani.

Ministri Tafaj takohet me Ministrin e Arsimit të Lartë dhe Shkencës të Landit të Bavarisë, Dr. Wolfgang Heubisch.

*Intervista Petrit Malaj
Rektor i Akademisë së Arteve*

Nga mësuesit shqiptarë, unë kam pritur dhe pres gjithmonë dashuri për profesionin e tyre, dashuri dhe korrektesë për atë ç'ka ata transmetojnë tek nxënësit dhe dashuri për shkollën, gjë të cilën unë nuk e vë fare në pikëpyetje.

*Vlerësimi vjetor i punës së mësuesit
Miranda Kurti*

Vlerësimi i punës së mësuesit përbën një proces shumë të rëndësishëm dhe delikat që lidhet me një sërë aspektesh të punës së tij si: karriera dhe ndryshimet e mundshme, formimi i tij profesional, dhe shkencor dhe statusi i tij profesional dhe social.



<i>Përmajtja:</i>	<i>fajqe</i>
Ministri Tafaj, i ftuar nderi në Ditën Akademike të Universitetit Otto-Friedrich të Bambergut, Gjermani	3
Ministri i Arsimit dhe Shkencës Dr. Myqerem Tafaj takon Ministrin e Arsimit të Lartë dhe Shkencës të Landit të Bavarisë, Dr. Wolfgang Heubisch	3
Trajnimi mbi realizimin e procedurave të prokurimit për ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve shkollore dhe shtimin e laboratorëve shkencorë	4
Intervista	5
<i>Arsimi & Reforma</i> Disa parime bazë mbi mësimdhënien e matematikës	6-7
Zhvillimet e edukimit për sipërmarrësi në Arsimin Profesional (AP) në Shqipëri	8-9
Të edukosh turizmin	10
<i>Mësuesi & Nxënësi</i> Cilësia e mësimdhënies	11-12
Orë model: Studim teksti "Kulla" e A. Pashkut	13-14
Fëmijët parashkollor në qendër të kujdesit	15
Nxënësi si person	16
<i>Arsimi & Komuniteti</i> Psiko - dëshmi 2 Inferioriteti si frikë, apo frika si premisë inferioriteti	17
Mbi supervizionin e shkollës si komponent themelor i sistemit të monitorimit të cilësisë arsimore	18-19
Vlerësimi vjetor i punës së mësuesit	20
<i>Reportazh</i> A. Andoni	23-25
<i>Tradite & Kulturë</i> Në shkollat shqipe në Maqedoni	27-28
<i>Ju pyesni, ne përgjigjemi</i> (Vijon) Kushtet për të përfituar pensione mësuesit dhe pedagoget për vitin shkollor 2010 - 2011	29
Shkolla jonë dhe projekti "Të njohim Europën"	30
Shtrengimi i dorës dhe sfumaturat e kuptimit	31

Shkolla shqiptare e medias dhe e komunikimit, po zhvillohet sipas standardeve ndërkombëtare

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, zoti Tafaj, ishte i ftuari i nderit, në konferencën shkencore ndërkombëtare "Media Shqiptare në Tranzicion"

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, zoti Tafaj, mori pjesë në konferencën shkencore ndërkombëtare "Media shqiptare në tranzicion" të mbajtur në sallën e Akademisë së Shkencave, e organizuar nga Departamenti i Gazetarisë së Universitetit të Tiranës, si i ftuar nderi i saj.

Në një mjedis sa akademik, aq edhe mediatik, e mori fjalën edhe ministri Tafaj. Kanë kaluar tashmë dy dekada në tranzicion dhe ne vijmë si shoqëri me një hapësirë të kënaqshme në aksesin ndaj medias, fjalës së lirë dhe komunikimit. Roli dhe vendi i medias në shoqërinë shqiptare, sikundër dhe kudo në botën e qytetëruar, ka qenë dhe mbetet i pazëvendësueshëm. Ne sot kemi një liri të shtypit, që lexuesi shqiptar e gjen të mëshiruar nëpër sa e sa gazeta ditore, televizione qendrore e lokale dhe radiove, pa lënë mënjanë edhe pjesën e informimit publik përmes internetit, -theksoi në fjalën e tij ministri Tafaj.

Fakultetet e gazetarisë si shkolla të medias dhe komunikimit, kanë një rol të madh dhe japin një ndihmesë të shquar në demokratizimin e shoqërisë shqiptare, por njëherazi duke përgatitur dhe gazetarë të zot, të cilët studiojnë dhe punojnë si gazetarë e reporterë të shtypit.

Është kënaqësi për ne, që nga maturantët më e dalluar dhe më të mirë të këtij viti, një pjesë e tyre, konkurrojnë dhe ndjekin degët e gazetarisë. Kjo është një arritje e Juaja.

Në këtë konferencë, ne ndodhemi përballë mjaft prej figurave të nderuara të gazetarisë shqiptare, që i kanë dhënë dhe i japin tonin jetës së shtypit në vend, porse ju jeni njëherësh edhe profesorë të nderuar të universiteteve tona të gazetarisë. Të rinj, studentë e gazetarë, me siguri ndjehen të privilegjuar të jenë pjesë e misionit të përbashkët të zhvillimit të mëtejshëm cilësor, si të fakulteteve të gazetarisë ashtu dhe medias në përgjithësi.

Në këtë këndvështrim Ministria e Arsimit do vijojë të mbështesë me gjithçka mundet modernizimin e mëtejshëm të programeve tuaj të studimit, kurrikulat e domosdoshme dhe deri në këmbimin përvojave dhe të profesorëve nga universitete e botës, gjë që tashmë pas liberalizimit të vizave është plotësisht e realizueshme.

Ne shpresojmë,- tha në fund të fjalës së tij zoti Tafaj, -se roli dhe qëllimi i shtypit dhe gazetarisë shqiptare do vijojë të jetë në shërbim të shoqërisë sonë të hapur dhe demokratike.

Ministri Tafaj takohet me një grup studentësh në Gjermani

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Z. Myqerem Tafaj, gjatë një vizite pune në Gjermani u takua më 6 Nëntor 2010 në Stuttgart me një grup studentësh dhe doktorantësh shqiptarë, që studiojnë në universitetet e Landit Baden-Wuerttemberg.

Ministri Tafaj bashkëbisedoi me studentët mbi zhvillimet në fushën e arsimit dhe shkencës në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë u diskutua mbi programet Brain Gain dhe Fondin e Ekselencës. Ministri theksoi domosdoshmërinë e zhvillimit të shpejtë të burimeve njerëzore me kualifikim të përshtatshëm për të përballuar sfidat e sotme në fushën e arsimit, shkencës dhe fushat e tjera të ekonomisë.

Në këtë kontekst, Ministri Tafaj theksoi se mbështetja e të rinjve të shkolluar në shkollat perëndimore luan një rol të rëndësishëm dhe përbën një prioritet të programit të Qeverisë Berisha. Më tej u diskutua edhe për mundësinë e angazhimit të kërkuesve shqiptarë që punojnë në universitetet perëndimore në aplikimet në kuadër të programeve ndërkombëtare të kërkimit, sidomos programet komunitare FP 7 dhe programet në fushën e kërkimit që ofrojnë agjencitë gjermane.

Ministri Tafaj, i ftuar nderi në Ditën Akademike të Universitetit Otto-Friedrich të Bambergut, Gjermani

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, zoti Myqerem Tafaj, me ftesë të Presidentit të Universitetit Otto-Friedrich të Bambergut Prof. Dr. G. Rupert mori pjesë në Ditën Akademike (Dies Academicus) të universitetit më 8 Nëntor 2010. Si i ftuar i nderit, Ministri Tafaj mbajti kumtesën me temë “Rëndësia e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në zhvillimin e Shqipërisë”.

Ministri Tafaj paraqiti fillimisht një përmbledhje diakronike të zhvillimeve të fundit në arsimin e lartë e më pas parashtrori tezat kryesore mbi sfidat me të cilat ndeshet arsimit dhe kërkimi shkencor në Shqipëri.

Në kumtesën e tij, Ministri Tafaj, u shpreh se zhvillimi i arsimit gëzon një rëndësi të veçantë për qeverinë shqiptare, e cila ka ndërmarrë një sërë reformash dhe nismash për t’i krijuar hapësira zhvillimit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Ndër angazhimet më të rëndësishme të qeverisë shqiptare, Ministri i Arsimit dhe Shkencës zoti Myqerem Tafaj, përmendi zgjerimin e sistemit të arsimit të lartë, integrimin e kërkimit shkencor me procesin e mësimdhënies pranë universiteteve, përfshirjen e teknologjisë së informacionit në mësimdhënie, nxitjen e inovacionit në kontekstin shqiptar të zhvillimit të shkencës si dhe rritjen e përpjekjeve institucionale për sigurimin e cilësisë.

Kumtesa e Ministrisë Tafaj u përcoll për një auditor të përbërë nga profesorë, studentë, rektorë universitetesh si dhe politikanë nga Land-i i Bavarisë në Gjermani. Në



përfundim, Ministri Tafaj pati mundësi të bashkëbisedojë dhe të shkëmbejë përvojën e tij me rektorët, profesorët dhe studentët e pranishëm.

Gjatë gjithë takimit, duke përmenduar problematikat dhe sfidat me të cilat përballet arsimit të lartë dhe kërkimi shkencor në Shqipëri, Ministri Tafaj konfirmoi vendosmërinë e qeverisë shqiptare dhe institucionit që ai drejton për të arritur objektivat e vendosura për të realizuar standarde europiane.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës Dr. Myqerem Tafaj takon Ministrin e Arsimit të Lartë dhe Shkencës të Landit të Bavarisë, Dr. Wolfgang Heubisch

Në vijim të vizitës së tij në Landin e Bavarisë dhe takimeve me personalitete të shquara në fushën akademike dhe të politikës, Ministri Tafaj pati një takim pune me Ministrin e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Dr. Wolfgang Heubisch, në Mynih më datë 9 Nëntor 2010. Në takim Ministri Tafaj shoqërohej nga Ambasadori i Republikës së Shqipërisë, Z. Valter Ibrahimimi dhe Kryetar i Konferencës së Rektorëve dhe Rektor i Universitetit të Tiranës z. Dhori Kule.

Në takim Ministri Tafaj shprehu fillimisht falënderimet e sinqerta për ndihmesën që Republika e Gjermanisë dhe Landi i Bavarisë i kushtojnë zhvillimit të arsimit dhe ekonomisë në Shqipëri. Më pas Ministri Tafaj i prezantoi homologut të tij nga Landi i Bavarisë zhvillimet e fundit dhe reformat në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri duke theksuar se qeveria është e angazhuar që në mandatin e dytë të saj t’i kushtojë vëmendje rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë, si dhe fuqizimit të institucioneve të sigurimit të cilësisë.



Ministri Tafaj, gjithashtu, propozoi si mundësi bashkëpunimi të mëtejshëm fushat e albanologjisë, formimit universitar të mësuesëve dhe të mjekëve, rritjen e kapaciteteve njerëzore në institucionet e sigurimit të cilësisë, mundësitë për shkëmbim të personelit akademik dhe shkencor etj. Ministri Tafaj kërkoi që këto mundësi bashkëpunimi të konkretizoheshin nëpërmjet një memorandumi mirëkuptimi midis Ministrisë së Arsimit

dhe Shkencës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Landit të Bavarisë.

Ministri Heubisch në fjalën e tij theksoi se ishte dakord që të ndërmerreshin hapa konkrete për të thelluar dhe zgjeruar fushat e bashkëpunimit me Republikën e Shqipërisë, pasi kjo do të ishte në interes të të dy vendeve. Gjithashtu Ministri Heubisch u shpreh i gatshëm për të shqyrtuar mundësinë e finalizimit të një memorandumi në fushën e arsimit të lartë dhe shkencës. Ministri Heubisch u shpreh me optimizëm se në të ardhmen Landi i Bavarisë do të angazhohej më shumë në programe të përbashkëta me Republikën e Shqipërisë.

Trajnimi mbi realizimin e procedurave të prokurimit për ndërtimin dhe rikonstrukcionin e objekteve shkollore dhe shtimin e laboratorëve shkencorë

Përgatiti: Dafina CENAJ - MASH

Një ndër objektivat kryesore të programit të qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës është përmirësimi i infrastrukturës arsimore dhe shtimi i laboratorëve shkencorë në të gjitha nivelet e arsimit, me qëllim përmirësimin e kushteve të mësimdhënies në shkolla në funksion të rritjes së cilësisë.



Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës, në zbatim të programit “Cilësi dhe Barazi në Arsim” me financim të Bankës Botërore, Bankës Evropiane të Investimeve dhe Bankës së Këshillit të Evropës për Zhvillim dhe Buxhetit të Shtetit për vitin 2010-2011, nga plani i aktiviteteve të shumta të planifikuara për tu realizuar po veçojmë vetëm disa në funksion të infrastrukturës dhe projekteve didaktiko-shkencore:

1 - Në Fushën prioritare 3 - “Përmirësimi dhe racionalizimi i infrastrukturës arsimore”, janë planifikuar për tu ndërtuar 15 shkolla të reja, rehabilitimi i 7 shkollave ekzistuese dhe zgjerimi i tre shkollave ekzistuese (rikonstruksion dhe shtesa).

2 - Në prioritetin 4 “Zbatimi i reformës në arsimin e lartë”, janë planifikuar për tu realizuar 25 projekte Didaktiko - Shkencorë në të gjithë universitetet e vendit.

Realizimi i këtyre aktiviteteve dhe kryerja e procedurave të prokurimit bëhet nga njësitë vendore dhe universitetet, nën asistencën e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në zbatim të Manualit Operacional të Programit (POM) mbi zbatimin e projektit Cilësi dhe Barazi në Arsim, sipas kriterëve dhe procedurave të Bankës Botërore.

Me qëllim ecurinë normale të procedurave dhe realizimin me efektivitet të tyre, në zbatim të

Urdhrit të Ministrit të Arsimit, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, gjatë periudhës 10-12 Nëntor u realizua trajnimi për punonjësit e bashkive dhe komunave përkatëse dhe Universiteteve, nën Konsulencën e Konsulentit Ndërkombëtar të Prokurimeve z.Eric Koenen.

Gjatë seancave të trajnimit u trajtua Manuali Operacional i Programit me të gjitha etapat dhe procedurat e prokurimit sipas aktiviteteve të parashikuar në planin e prokurimit për këto autoritete kontraktues.

Pjesëmarrësit në këtë trajnim, diskutuan dhe bënë prezent të gjitha problemet dhe vështirësitë që ata hasin në realizimin e procedurave të prokurimit, si dhe u trajtuan të gjitha pyetjet e ngritura nga përfaqësuesit.

Më datë 11.11.2010 u trajnuan specialistët e universiteteve mbi realizimin e procedurave të prokurimit të projekteve didaktiko-shkencor (UNILAB), ndërsa dy ditet e tjera u trajnuan specialistet e bashkive dhe komunave për procedurat e prokurimit të ndërtimit dhe rehabilitimit të objekteve shkollore dhe procedurat e konsulencës për supervizimin e punimeve.

Me qëllim, realizimin e projektit (CBA) brenda vitit 2011, në kuadrin e forcimit të drejtimit dhe menaxhimit, përmirësimin e kushteve për mësimdhënien, përmirësimi në vazhdimësi i infrastrukturës dhe shtimi i laboratorve didaktik shkencorë për realizimin e reformës në arsimin e lartë, po punohet maksimalisht nga të gjitha palët për përfitimin maksimal të këtij donacioni.

Është shumë e rëndësishme që të japim imazhin pozitiv në administrim dhe menaxhim dhe njëkohësisht të bëhemi partnerë të besueshëm në përfitimin e kredive të tjera dhe gjetjen e burimeve të tjera financimi në dobi të arsimit.



Intervista me Petrit Malaj, Rektor Akademia e Arteve

Cili do të ishte mesazhi juaj për mësuesit shqiptarë sot? Çfarë prisni nga ata?

Se pari, e ndiej veten të nderuar që me jepet mundësia të komunikoj me atë pjesë të inteligjencës shqiptare e cila më mirë se kushdo ka bërë një punë të jashtëzakonshme, jo vetëm në edukimin e të rinjve shqiptarë, por edhe në plotësimin e tyre me dije, me atë ç'ka është e nevojshme në marrëdhënie me njëri-tjetrin, jo vetëm në Shqipëri, po kudo në botë. Ushqej respektin më të madh për këtë pjesë të çmuar të kombit që bëjnë një detyrë kaq fisnike. Të gjithë e kemi kaluar këtë moment dhe në një lloj mënyre unë jam pjesë e kësaj fushë, pasi edhe Arsimi i Lartë është pjesë e edukimit arsimor për të nesërmen e tyre. Nga mësuesit shqiptarë, që të jem i sinqertë, unë kam prituri dhe pres gjithmonë dashuri për profesionin e tyre, dashuri dhe korrektesë për atë ç'ka ata transmetojnë tek nxënësit dhe dashuri për shkollën, gjë të cilën unë nuk e vë fare në pikëpyetje dhe e has përditë, me të gjitha personat që militojnë në këtë fushë kaq të rëndësishme të vendit tonë, siç është arsimi.

A besoni se mësuesit kanë influencën më të madhe në shoqëri? Cila periudhë e historisë së arsimit shqiptar ka pasur influencën më të ndjeshme në zhvillimet historike të kombit tonë?

Për mendimin tim, mësuesit kanë influencë shumë të madhe në shoqëri. Nisur nga misioni që ata kanë, kanë të bëjnë me shumë elementë të jetës së shoqërisë shqiptare. Po të vëmë re, në çdo hap tonin dhe kudo që shkojmë, ne nuk rrimë dot pa përmendur emrin e njeriut të nderuar, të mësuesit. Mësuesi jo vetëm për fëmijët tanë, por për gjithë shoqërinë shqiptare, përben një shtyllë të fuqishme të edukimit dhe të gjithëçkaje që ka të bëjë me jetën. Mësuesi, dua të them, është një simbol i mirësisë në këtë vend.

Unë mendoj se në çdo epokë të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, aspekti i edukimit ka një peshë të madhe. Pa mësuesin dhe pa edukimin, shoqëria nuk mund të njohë ecuri. Edhe në kohën e diktaturës, por sidomos sot, kur mësuesi kërkohet që të jetë i specializuar dhe të ketë një formim shumë më të mirë dhe më të lartë në dijet që ai transmeton tek fëmijët, ka mbajtur një peshë të madhe. Profesionin e mësuesit nuk e gëzon kushdo, ky profesion është i nderuar dhe i respektuar, por që duhet ta meritosh dhe, unë mendoj, që ta meritosh këtë patjetër, duhet të punosh shumë.

Cili ka gene mësuesi me i mire për ju?

Eh, (qesh). Unë kam patur, ashtu si të gjithë ne, shumë mësues, por duam apo nuk duam ne, veçojmë ata, mësuesit e fëmijërisë. Unë veçoj një mësuese timen të parë që quhet Gjylfidane Hila dhe e kujtoj me shumë respekt dhe sa herë e takoj i përulëm asaj për gjithçka ka bërë me një dashuri të jashtëzakonshme, me një zemër të madhe, por dhe me një profesionalizëm shumë të mirë. Ajo ishte këmbëngulëse me ne, duke filluar nga mënyra si ne duhet të shkruanim, apo të logjikojmë dhe të komunikojmë mbi gjithçka që duhet të transmetonin, ka qenë një mrekulli. Nëse flas me shumë dashuri për mësuesin, do të flas po kështu edhe kur të jem me mjekër.

Çfarë kontributi ka Akademia e Arteve në sistemin arsimor shqiptar?

Akademia e Arteve është një Institucion i Arsimit të Lartë që në misionin e vet ka edukimin profesional të artistëve të rinj. Në objektin që ka, zë një pjesë të madhe në strategjinë e zhvillimit të vendit tonë, sepse arti dhe kultura janë ndër kolonat më të fuqishme të zhvillimit të një shteti. Padyshim, kjo për vetë gamën e fushës që zë, Akademia e Arteve flet shumë dhe gjithçka që ne bëjmë nuk ngelet brenda këtyre katër mureve, por gjithçka ne përpiqemi ta shpërfaqim dhe ta shpallim në publikun e gjerë. Për punën që është bërë në Akademinë e Arteve në këtë periudhë mbi 50-vjeçare të saj, flasin të gjithë ata që kanë mbaruar Akademinë e Arteve. Nuk po e specifikoj, sepse jo të gjithë kudo dhe

në çdo fushë nuk bëjnë më të mirën e mundshme, por ju siguroj që të diplomuarit në Akademinë e Arteve kanë folur fuqishëm jo vetëm në Shqipëri e Tiranë, por shumë mirë edhe në botë dhe për këtë kemi shembuj konkretë. Emra të fuqishëm si Inva Mula, apo dhe të tjerë që luajnë në orkestrat e Evropës, apo deri në operën dhe baletin e SHBA-ve dhe të tjerë që kanë shpallur vlerat e tyre me forcë në fushën e arteve pamore. Kjo flet më se miri që diploma që merret në Akademinë e Arteve dhe misioni për të cilin ne i përgatisim këta të rinj, ka një lidhje të drejtpërdrejtë me tregun mision të cilin e ka dhe diplomimi që ne ju bëjmë këtyre studentëve.

Ne tani jemi në një fazë shumë interesante të zhvillimit të Akademisë së Arteve, kemi implementuar Kartën e Bolonjës, jemi në implementim e saj në ciklin e dytë. Vitin tjetër do të hapim këtë cikël, ku do të bëhet e mundur të specializojmë shumë më ngushtë këto programe studimi që kemi, por nga ana tjetër, do të krijojmë edhe dritare të ndryshme që studentë të tjerë të kenë mundësi të vijnë në Akademi edhe nga fakultetet të tjera që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me artin si p.sh. Fakulteti Filologjik, apo dhe të tjera.

Cili është vizioni i Akademisë në përputhje me ndryshimet e shpejta rajonale e evropiane të zhvillimit?

Akademia e Arteve, së shpejti, do të bëhet Universitet dhe të bërit Universitet është një hap tjetër në ridimensionimin e misionit dhe të objektit që ka ky institucion. Institucioni jonë si një institucion unik kombëtar i arsimit publik në Shqipëri, pra Akademia e Arteve, mendoj se do ta thotë shumë më fuqishëm fjalën e saj dhe se do të bëjë të mundur që të gjithë të rinjtë që do të zgjedhin këtë shkollë dhe do të zgjidhen nga specialistët përkatës për të qenë pjesë e stafit të studentëve të Akademisë së Arteve, mendoj se do të bëjnë një punë shumë profesionale. Por të bërit Universitet do të ndikojë edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare që ne do të ndërtojmë dhe çojmë më tej akoma. Të mos harrojmë se terminologjia "Akademi" është një cilësim pak më i ulët se ai universitar, por tashmë unë mund të them me plot gojën se Akademia është Universitet, pasi ka 3 fakultete me departamentet përkatëse, pra ka një strukturë universitare ku gjithçka funksionon si një universitet. Gjykoj që jo vetëm nga ana akademike, por dhe nga ana tjetër, Akademia e Arteve po bën një punë shumë të madhe porsa i takon lidhjes së studentëve dhe pedagogëve me tregun. Ne tashmë po implementojmë një projekt, "Programi -qyteti i arteve" një ndihmë e Qeverisë shqiptare, në të cilin janë shpallur fitues rreth 34 projekte artistike në teatër, film, muzikë dhe arte pamore, ku përfitues të këtyre projekteve do të jenë studentët dhe pedagogët e Akademisë së Arteve dhe kjo do të bëjë të mundur që, vërtet, Akademia e Arteve me forcat e saj potenciale që ka. qoftë në rrafshin pedagogjik dhe atë studentor, të shpallë më se miri vlerat e saj krijuese.

Mesazhi juaj për nxënësit e studentet shqiptare.

Duhet shumë punë për të arritur aty ku mendon gjithsecili dhe, çdo nxënës e student, mendoj që e ka të qartë që nuk ka ardhur këtu për të marrë një diplomë, por ka ardhur që nesër t'i shërbejë kombit shqiptar.



Disa parime bazë mbi mësimdhënien e matematikës

Objektivi i këtij shkrimi është që nëse mësuesi i matematikës i përvetëson dhe i praktikon në mënyrë të vazhdueshme dhe krijuese këto parime, atëherë ato do t'i shërbejnë atij si një mbështetje drejt mësimdhënies efektive

Në fushën e matematikës, specialistët mësimdhënës të saj, në përgjithësi i kushtojnë pak kohë dhe vëmendje plotësisht të kulturës së tyre me njohuri nga pedagogjia e psikologjia. Madje, nga kontaktet shumëvjeçare me ta, kemi vënë re se një pjesë jo e paktë e tyre, e nënvleftësojnë këtë aspekt shumë të rëndësishëm të procesit të mësimdhënies.

Zakonisht, mësuesit e matematikës kanë një mënyrë specifike operimi dhe të menduari për vetë natyrën e lëndës dhe formimi i tyre akademik. Ata mendojnë në mënyrë analitike; fokusohen kryesisht në qëllimin e gjetjes së zgjidhjes së problemit që u parashtrahet, pavarësisht natyrës së problemit. Ata edhe një problem social shpesh e trajtojnë si problem matematik, duke marrë parasysh vetëm të dhëna logjike që lidhen me problemin. Ndërkohë që të menduarit pedagogjik e psikologjik kërkon një të menduar paksa me një spektër më të gjerë, që ka si qëllim të formulojë një sërë zgjidhjesh që mund të përdoren në raste të ndryshme, kur ndoshta informacioni mbi situatën nuk është aq i plotë, duke i pasur në dispozicion të gjitha të dhënat e mundshme që kërkon zgjidhja e një problemi matematik si e mendon mësuesi i matematikës.

Ka mësues matematike që fillimisht operojnë me të dhënat dhe "dorëzohen" nëse ato nuk janë të mjaftueshme sipas logjikës së tyre, në zgjidhjen e problemit. Pa u menduar shumë thonë se "ky problem nuk ka zgjidhje, pra me kaq e zgjidha". Spektri pedagogjik e psikologjik i mësimdhënies lidhet me informacion shumë të gjerë që ka të bëjë si me njohuritë dhe kulturën e mësuesit për të interpretuar faktet, por edhe me natyrën e tridhjetë e më shumë nxënësve e prindërve të një klase e, njëkohësisht, dhe të natyrës së kolegëve të tjerë që japin mësim në këtë klasë. Pra ka të bëjë me ndjenja e qëndrime, që shpesh janë të personalizuar, lidhen me natyra individësh e rrethana formimi të tyre nga më të ndryshmet, të cilat kërkojnë vëmendje të veçantë. Rrjedhimisht, duhet pasur parasysh që edhe përvetësimi i njohurive matematike nuk është i lidhur thjesht vetëm me aftësitë akademike specifike e metodike të paraqitjes së njohurive nga mësuesi. Ato duhet të shihen të përshtatura me gjithë mjedisin bashkëveprues e të interesuar direkt, ose jo me këtë proces.

Më poshtë po parashtrajmë disa parime, të cilat mendojmë se ndihmojnë në mbështetjen e mësuesve të matematikës në procesin e mësimdhënies, për të qenë sa më efektivë, duke i praktikuar ato sipas rastit dhe nivelit të nxënësve, mjedisit rrethues, etj.

Pyetjet e mëposhtme mendojmë se do të na ndihmojnë për ta parë këtë çështje më gjerë dhe do të na çonin drejt një arsytimit më të mirë:

Së pari: A do të ishte e nevojshme apo e mjaftueshme që t'u jepnim mësuesve të matematikës një listë të detajuar me "këshillat më të mira", apo 10 teoremat e mësimdhënies, ose një manual me shumë faqe, ku të jenë të përfshira të gjithë rregullat e mësimdhënies perfekt?

Nga Prof. As. Sotir RRAPO, Prof. As. Hysen BINJAKU
Pedagogë në UET

Nëse ata do t'i mësonin përmendesh të gjithë algoritmet e rregullat e paracaktuara dhe do të bënin të gjitha përpjekjet për t'i realizuar në praktikë këto, a do të na çonte kjo në një mësimdhënie të përsosur dhe me rezultate maksimale në një klasë të caktuar me nxënës, prindër e kolegë, të cilët i njohim mirë ose jo në shkallën e duhur.

I. Burimet kohore dhe burimet e tjera që lidhen me të

Në mësimdhënie dhe nxënie përdoret një burim apo aset i kufizuar që është koha, e cila është e kufizuar si për mësuesin ashtu edhe për nxënësin. Flitet për ta paraqitur e përpunuar një koncept apo njohuri të caktuar në një njësi kohe prej 45-60 minutash dhe në këtë kohë duhet të zhvillohet, si të themi, një "betejë" midis mësuesit që bën përpjekjet maksimale për të pozuar njohuritë dhe masës së nxënësve që jo në shkallën e mësuesit, për shumë arsye, janë të përqendruar për kohën në dispozicion të ndjekin mësuesin qoftë ai dhe më i pasionuari. Nuk është e lehtë që përqendrimi i nxënësve të jetë maksimal në të njëjtën shkallë gjatë gjithë kohës, si për arsye të moshës, por dhe të përgjegjësisë që kanë për atë që mësojnë apo dëgjojnë. Këtu mund të shkohet dhe më tej, bashkë me nxënësit mësuesi do të realizojë një program të caktuar njëvjeçar e më shumë.

Pra, ky parim, megjithëse në dukje është tepër i qartë dhe i thjeshtë, shpesh nuk i jepet vendi i duhur në praktikë. Në përgjithësi mësuesi, për shkak të një pune shumëvjeçare me konceptet e njohuritë, por dhe të ndryshimit të tij me nxënësin që ka përpara, harron të pyesë veten: Sa kohë do të dojë nxënësi për të bërë këtë apo atë detyrë shtëpie? Sa kohë do të duhet që një koncept i matematikës të mund të përpunohet në nivel qartësimi mesatar apo shumë të mirë për nxënësit. A ka kohë që të përgatisë materialin për njësinë mësimore që ka planifikuar dhe sa kohë duhet për ta transmetuar atë? Le ta ilustrojmë këtë me një shembull: Mësuesi ka rreth 20 vjet që shpjegon se si zgjidhet një ekuacion i shkallës së dytë apo dhe më thjesht, një ekuacion i shkallës së parë apo konceptet e limitit, derivatit e integralit të funksionit dhe për të kjo është kthyer tashmë në një rutinë, madje dhe bezdi dhe ka harruar se sa kohë dhe vetë atij i është dashur që ato t'i qartësojë duke pasur në shumicën e rasteve parasysh se mësuesit e matematikës kanë pasur dhe një prirje të veçantë për lëndën. Nxënësit që ndeshen për herë të parë me njohuri e koncepte, shpesh abstrakte për ta, sigurisht që do t'u duhet kohë të familjarizohen dhe mësuesi nuk duhet të shqetësohet, nuk duhet t'i ngutë ata dhe aq më shumë nuk duhet t'i fyejë e de motivuar duke u shprehur „Si nuk e zgjidhni këtë ushtrim, ky është fare i lehtë! Ja shikoni sa shpejt e zgjidh





unë". Ose duke ngritur shpesh nxënësin më të mirë të klasës u thotë „Ja dhe shoku juaj X sa shpejt e zgjidhi ushtrimin ose problemën, bile dhe pa ndihmën time”. Duke mos marrë në konsideratë këtu se nxënësi që ka ngritur para këtij të fundit mund të jetën me prirje të shkëlqyera në muzikë, histori, biologji, apo lëndë të tjera.

Kjo mënyrë të komunikuar nuk bën gjë tjetër veçse frenon e dekurajon nxënësin me përparim jo të mirë apo të ngadaltë, të cilët ose e ndjekin procesin me vështirësi ose demoralizohen plotësisht. Në matematikë mund të ecet shpejt vetëm duke i përvetësuar njohuritë ngadalë por qartë. Po qe se njohuritë matematike mësohen shpejt, përmendësh e të paqarta ato, nuk do të harmonizohen natyrshëm me konceptet e njohuritë e tjera dhe do të harrohen ose do të jenë fragmentare dhe pa mundësi zbatimi në një të ardhme jo shumë të largët.

II. Dimensionin profesional dhe njerëzor:

Mësimdhënia dhe nxënia si dhe në shumë lëndë të tjera dhe në matematikë kanë dy dimensione, dimensionin profesional dhe atë human. Menaxhimi i kurrikulës si dhe ndërveprimi me nxënësit kërkon përdorimin e të dy dimensioneve.

Mësimdhënia ka gjithmonë si element të saj **ndërveprimin** me nxënësit, i cili mund të ketë një efekt emocional dhe psikologjik mbi ta. Në kontekstin normal të marrëdhënieve njerëzore, në familje apo me shoqërinë ne e nxjerrim inatin duke u bërë më agresivë apo qoftë edhe duke derdhur lot. Asnjë nga këto dukuri nuk lejohet ta pushtojnë qoftë dhe pa dashje mësuesin, i cili duhet të jetë gjithmonë nën kontroll dhe të zgjidhë situatën në mënyrë profesionale. Mësuesi duhet të punojë mirë si me nxënësit që i pëlqejnë por edhe me ata që “nuk i ka për zemër”. Diferencimi në klasë sjell shpesh pakënaqësi të padukshme, të cilat zhvillohen brenda secilit nxënës e mund të marrin jetë si një ortek i papritur në një moment kur mësuesi nuk e pret. Ai duhet t’i gjykojë nxënësit si njerëz që kanë dëshirë të mësojnë dhe jo si njerëz që kanë një aftësi të lindur matematikore apo dhe mundësi të përhershme për të qenë të vëmendshëm ndaj mësuesit.

Si në shumicën e ndërveprimeve mes njerëzve, mësuesi duhet të kuptojë se për ta bërë mirë punën e tij ai duhet të përshtatë karakterin, të “luaje teatër” pak dhe të kontrollojë sjelljen e tij. Stereotipi i mësuesit të çorganizuar dhe të hutuar të matematikës, që është kaotik në shumicën e aktiviteteve, nuk u vjen sa duhet e si duhet nxënësve në ndihmë. Është pjesë e profesionalizmit që mësuesi ta kuptojë këtë dhe të korrigjojë sjelljen e tij për të minimizuar efektet negative mbi nxënësit. Shumë nga mësuesit e matematikës, për arsye nga më të ndryshmet, po dhe vetë natyrës së lëndës, janë pak të hutuar, harrojnë takimet, afatet e njohjes së nxënësve me detyrat, kalojnë në disa raste në kërkesa tepër të sakta e strikte, të cilat më tej bëhen shkak konflikti, “hapin shumë kllapa”, duke paraqitur probleme dhe harrojnë t’i mbyllin

duke humbur fillin e bisedës, etj. Disa mësues janë arrogantë dhe të paduruar kur merren me nxënësit që punojnë ngadalë duke u krijuar atyre stresin e ngutjes, të bllokimit të të menduarit dhe të bërjes së gabimeve për këtë arsye.

Këto lloj sjelljesh duhen mënjanuar edhe nëse nuk e ndjeni të nevojshme shumë për nxënësit, si mësues duhet të paktën të lini dhe përshtypjen sikur vërtet jeni të interesuar për ata.

Një ndër principet kryesore të mësimdhënies së suksesshme është respekti ndaj nxënësve.

Pse po e theksojmë kaq shumë rëndësinë e aspektit njerëzor? Pikërisht sepse në aktivitetet matematikore emocionet apo dobësitë njerëzore nuk janë shumë të rëndësishme, pra ato nuk merren parasysh nga mësuesi, ndërkohë që ato mund të jenë në dobi të punës.

Për mësuesit të cilët shpesh e mbingarkojnë veten, pikërisht është kjo mundësi për t’u përqendruar plotësisht në zgjidhjen e një problemi të vështirë, duke harruar mjedisin dhe rrethanat në të cilat vepron ose të mbajë në konsideratë shqetësime të tjera që kanë të bëjnë me nxënësit apo të tjerë. Një mësues paksa arrogant ka vetëbesimin e mjaftueshëm të këmbëngulë dhe të arrijë zgjidhjen e duhur. Në këto raste është e nevojshme për t’u vënë re një gjë, problemi dhe zgjidhja nuk zhduken dhe as nuk ndikohen nga emocionet apo dobësitë personale. Nëse mësuesi është i nxehur dhe hedh tutje me inat shkumësin apo llogaritë që nuk po i dalin, problemi do vazhdojë të presë aty me durim, derisa ai të qetësohet.

Një gabim në sjellje jo vetëm që mund të ndryshojë „problemin“ por mund të shkatërrojë edhe ndonjë shans minimal për ta zgjidhur atë. Po ashtu, nëse mësuesi sillet siç duhet dhe krijon raportin e duhur me nxënësit, atëherë mund të ketë një efekt shumë pozitiv që përforcon dhe kalon përtej aftësive të tyre profesionale dhe teknike.

III. Qartësia dhe saktësia

Mësuesi duhet të paraqesë me qartësi dhe saktësi detyrën që i jep nxënësit dhe, gjithashtu, kriteret sipas të cilëve do vlerësohet. Asnjë nga akademikët, profesorët nuk kanë dëshirë të lexojnë një dokument që nuk e ka qëllimin dhe objektivin e shprehur qartë. Asnjë nga profesorët pra dhe vetë mësuesi këtu, nuk ka dëshirë të aplikojë për një projekt nëse kriteret nuk janë të përcaktuara qartë. Mundohuni ta vini veten në vend të nxënësit që ndjehet i pafuqishëm dhe tepër i vogël në një ambient të ri ku sapo ka hyrë. Ne nuk mund të arrijmë atë që duam prej tyre nëse nuk jemi konkretë dhe të qartë në lidhje me kërkesat tona.

Përmbajtja e lëndës, objektivat e saj, aktivitetet apo detyrat mësimore si dhe kriteret e vlerësimit duhet të shpallen të gjitha në mënyrë të qartë. Askush nuk mund të përpunojë informacionin siç duhet nëse ai nuk është strukturuar në mënyrë të saktë. Doemos që interpretimi është pjesë e procesit të nxënies dhe mësimdhënies por, kryesisht njerëzit mësojnë në mënyrë më efektive nëse objektivat, qëllimi dhe kriteret e vlerësimit janë të qarta për ta. Nuk ka arsye pse gjërat të bëhen artificialisht të komplikuar. Pra mësuesi ka shumë në dorë për të motivuar secilin nxënës. Para objektivave maksimale të përvetësimit të njohurive që shpallen, ai është mirë që të ketë të qarta dhe këto t’i thotë hapur dhe në përshtatje me mundësitë reale të secilit nxënës, duke përpunuar në bashkëpunim me ata një plan individual progresiv, i cili të shqyrtohet periodikisht. Është shumë e rëndësishme që rezultatet që një nxënës ka arritur në një test apo detyrë t’i argumentohen atij se pse janë ato rezultatet dhe jo ndryshe dhe nëse janë ndryshe pse?

Mësuesi ndodh edhe të ketë bërë gabim në vlerësim për arsye nga më të ndryshmet. Ai duhet të ketë kurajën që të bëjë rivlerësimin e nxënësit, duke i kërkuar atij edhe të falur dhe duke i shpjeguar se si ka vepruar për ta vlerësuar në atë mënyrë.

Zhvillimet e edukimit për sipërmarrësi në Arsimin Profesional (AP) në Shqipëri

Të mësuarit për sipërmarrjen tashmë është një nga drejtimet e rëndësishme të politikës europiane dhe globale që synon krijimin e një ambienti gjithnjë e më favorizues ndaj zhvillimeve ekonomike dhe sociale dhe, si e tillë, është bërë pjesë e rëndësishme edhe e agjendës politike arsimore dhe kornizës kurrikulare në Shqipëri.

Marsela Robo, AKAFP

Konceptet e të mësuarit dhe të praktikuarit për sipërmarrje janë ende jo shumë të njohura në AFP në Shqipëri. Koncepti i ngushtë i sipërmarrjes si “aftësi për të filluar dhe çuar përpara një biznes” ka influencuar fort në pjesën më të madhe të ndërhyrjeve në kurrikula dhe në proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies që lidhen me to, përsa i përket kësaj çështjeje.

Është për t`u përmendur që pothuajse të gjithë donatorët e projekteve që kanë mbështetur AFP në Shqipëri, gjatë 10-15 vjetëve të fundit, kanë qenë nxitësit kryesorë të futjes së `sipërmarrjes` në këtë sektor.

Ristrukturimi i arsimit të mesëm profesional (nga 4 vjet në 3+2) i cili filloi në vitin 1993, u shoqërua me një proces rishikimi të kurrikulave për të gjitha profilet profesionale që ofroheshin në shkollat e AP. Në sistemin formal të edukimit u realizuan disa ndryshime në kurrikula edhe në prezantimin e bazave të ELP (Entrepreneur Learning Program), në kurrikulat e edukimit të detyrueshëm. Në kornizën e zhvillimit të kurrikulave u desinjua nga ish-Instituti i Standardeve dhe Kurrikulave një kurrikul e re “Edukata shoqërore” për klasën e tretë dhe të shtatë me koncepte shumë bazike për sipërmarrjen.

Në arsimi fillor dhe 8-vjeçar (6-15 vjeç), në klasën e parë të shkollës fillore, nxënësit filluan të marrin njohuritë e para për ekonominë, nëpërmjet edukatës shoqërore e cila vazhdon deri në klasën e shtatë. Kjo lëndë zinte 3.88 % të kurseve të edukimit fillor. Në klasën e 8-të u realizua një tjetër kurs i quajtur edukimi ekonomik. Në këtë kurs nxënësit filluan të marrin me shumë njohuri të detajuara për ekonominë.

Në arsimin e mesëm (15-18 vjeç), ky nivel i përbërë nga shkollat e përgjithshme dhe profesionale kishte një përmbytje të ELP që zinte 1.8 - 3.4% të të gjithë kurseve.

Ndryshime ndodhën gjithashtu në kurrikulat për profilet mekanik makinash, përpunim druri, ndërtim, hidraulik, ku, në klasën e tretë u zhvillua një lëndë e quajtur “Organizimi, ligji dhe ekonomia” me përmbytje ELP, me një total prej rreth 70 orësh mësimore, e cila u fut në të gjitha profilet profesionale. Kjo lëndë, e cila u zhvillua në vitet e fundit të shkollimit, kishte si synim kryesor “të përmirësonte njohuritë e nxënësve në aspektet organizative, ligjore dhe ekonomike lidhur me punësimin e tyre të ardhshëm”. Ish-Instituti i Studimeve Pedagogjike hartoi planet mësimore për

këtë lëndë, sipas perceptimit tradicional (dhe të ngushtë) të “sipërmarrjes”. Përmbytjet kryesore të kësaj lënde i referoheshin pyetjeve të tilla si:

- Cilat janë strukturat organizative dhe si të organizosh vendin e punës në profesionin tënd?
- Cili është legjislacioni aktual në profesionin tuaj dhe si ta interpretosh atë?
- Si ta fillosh dhe si ta menaxhosh një biznes të vogël?
- Si të llogaritësh kostot dhe fitimet e prodhimeve dhe shërbimeve në profesionin tënd?

Sigurisht që kjo lëndë ishte e njëjtë për të gjitha profilet profesionale (pa marrë parasysh veçoritë e tyre) dhe varej nga mësuesit përshtatja e përmbytjes me profilin përkatës. Impakti i kësaj lënde në zhvillimin e shpirtit të sipërmarrjes të nxënësit e shkollave profesionale ishte shumë i kufizuar, së pari, për konceptimin shumë të ngushtë; së dyti, për mungesë njohurish të mësuesve që japin lëndën dhe së treti, për shkak të mungesës së kompetencave të mësuesve.

Me zbatimin e kornizës së re kurrikulare për arsimin e mesëm, (i përgjithshëm dhe profesional) që nga shtatori i vitit 2009, nxënësit zhvillojnë një lëndë të re të quajtur “Edukimi për karrierë”,

e cila zhvillohet përgjatë 2 viteve (kl. 10 dhe 11) në 54 orë mësimore. Kjo lëndë synon të zhvillojë te nxënësi aftësi për të zbuluar mundësitë e karrierës, si dhe për të vetëvlerësuar interesat dhe prirjet e veta me qëllim vendimmarrjen për shkollimin/trajnimin e mëtejshëm dhe punësimin, për të qenë pjesëtarë funksionalë të shoqërisë. Formimi i karrierës është një proces që zgjat gjatë gjithë jetës. Ai fillon në familje, zhvillohet gjatë periudhës së shkollimit si dhe përvojave të punës dhe shfaqet/ njehsohet me aftësinë e individit për të marrë vendime për të ardhmen e tij, në përshtatje me statusin e kualifikimit dhe me ndryshimet e tregut të punës.

Siç e theksuam edhe më lart, kjo lëndë është pjesë e kurrikulës shkollare edhe të shkollave të mesme profesionale dhe i përket pjesës së formimit të përgjithshëm. Për vetë specifikën e këtyre shkollave, kjo lëndë, megjithëse shumë e dobishme për formimin e nxënësve, është e pamjaftueshme për pajisjen e tyre me kompetencat sipërmarrëse. Për këtë





arsye, lindi nevoja për të futur të mësuarit të sipërmarrësisë në kurrikulën e shkollave profesionale si pjesë e formimit profesional.

Rrugët kryesore të futjes së konceptit të sipërmarrjes në praktikën e shkollës janë:

- sipërmarrja si lëndë e veçantë në kurrikul
- sipërmarrja si një çështje kros-kurrikulare
- sipërmarrja e futur në metodologjinë e mësimdhënies dhe të mësimnxënies

Për një sërë arsyesh, u mendua që të futej sipërmarrja si lëndë e veçantë në kurrikulën e shkollave të mesme profesionale. Ndërkohë që nuk përjashtohen, madje rekomandohen, edhe dy rrugët e tjera (sipërmarrja si një çështje kros-kurrikulare dhe sipërmarrja e futur në metodologjinë e mësimdhënies dhe të mësimnxënies).

Tashmë është përgatitur nga sektori i kurrikulave në AKAFP drafti i lëndës profesionale “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, lëndë e cila do të zhvillohet 2 orë në javë duke filluar nga viti i ardhshëm shkollor. Është patur kujdes nga grupi i punës që të kapen aspektet kryesore të sipërmarrësisë duke patur parasysh edhe kërkesat e nivelit (II) në të cilin do të zhvillohet. Disa nga temat e përmbajtjes së kësaj lënde janë: a-Njohuri të përgjithshme mbi sipërmarrjen; b-Sipërmarrja dhe veprimtaria njerëzore; c-Sipërmarrja dhe biznesi; d- Organizimi i punës në biznes; e- Tregu dhe sjellja konsumatorë-Institucionet financiare; g-Njohuri për marketingun; j-Legjislacioni dhe etika e biznesit k-Legjislacioni i punës; l-Llogaritje të thjeshta ekonomike; m- Aspekte të TIK-ut në biznes.

Përveç futjes si lëndë teorike profesionale, aspekte të veçanta të kompetencës së sipërmarrësisë do të pasqyrohen edhe në përmbajtjet e moduleve profesionale praktike. Në nivelin III (kl.13) do të theksohen aspektet menaxheriale të kompetencës në përputhje edhe me përshkrimin e nivelit. Në këtë mënyrë Shqipëria i bashkohet atyre vendeve europiane të cilat e kanë të shprehur qartë në kurrikulën e tyre shkollorë kompetencën e sipërmarrësisë dhe që të mësuarit për sipërmarrësi e realizojnë nëpërmjet një lënde teorike të detyruar për t`u zhvilluar në të gjitha shkollat e mesme teknike dhe profesionale, pavarësisht nga profili. Në udhëzimet met-

odologjike që shoqërojnë programin analitik të lëndës vihet theksi te fakti që punët praktike, apo orët e ushtrimeve duhet të përshtaten me profilin përkatës profesional. Meqenëse kjo lëndë vjen si një risi në kurrikulën e shkollave profesionale dhe duke qenë të ndërgjegjshëm për vështirësitë e mundshme në procesin e mësimdhënies së saj, AKAFP ka menduar të përgatisë edhe një udhëzues metodologjik në ndihmë të mësuesve. Gjithashtu, do të nevojiten edhe trajnime për ata mësues të cilët do ta japin këtë lëndë në shkollat profesionale. Koncepti i sipërmarrësisë është relativisht i ri në kurrikulën shkollorë të arsimit të mesëm në Shqipëri, ndërkohë që Europa ka krijuar tashmë një traditë të mirë të cilën synon ta përmirësojë. Futja e lëndës “Bazat e sipërmarrjes” si pjesë e detyruar në kur-

rikulin e shkollave profesionale, është një pikënisje e mirë, e cila sigurisht që nuk duhet mbyllur këtu. Kompetenca e sipërmarrësisë është shumë e gjerë dhe rrugët e mënyrat për mësimin e saj janë të shumta, prandaj nuk mund të pretendohet që me futjen e një lënde, qoftë kjo dhe e detyruar, ne e kemi përfunduar procesin.

Të mësuarit për sipërmarrjen tashmë është një nga drejtimet e rëndësishme të politikës europiane dhe globale që synon krijimin e një ambienti gjithnjë e më favorizues ndaj zhvillimeve ekonomike dhe sociale dhe, si e tillë, është bërë pjesë e rëndësishme edhe e agjendës politike arsimore dhe kornizës kurrikulare në Shqipëri. Fusha e edukimit për sipërmarrësi në shkollat tona pritet të jetë plot me opinione, kontradikta dhe pritshmëri dhe do të përballet me sfida të ndryshme.

Sfida e parë ka të bëjë me lidhjen ende inekzistente (përjashtuar disa raste sporadike) shkollë-biznes për shkak të qëllimeve shumë të ndryshme që kanë.

Sfida e dytë ka të bëjë me përmbajtjen e edukimit për sipërmarrësi. Koncepti në vetvete është shumë i gjerë prandaj duhet të kihet parasysh edhe në metodat e mësimdhënies dhe lidhjen ndërlëndore, krahas zhvillimit si lëndë e veçantë.

Sfida e tretë ka të bëjë me natyrën e mësimdhënies. Korniza e re kurrikulare e Arsimit Profesional, e cila është në vitin e dytë të zbatimit, ka rritur shkallën e lirisë së shkollës dhe mësuesit. Liria në vetvete është virtyt por, kur aktorët, në rastin tonë mësuesit, nuk kanë njohuritë e nevojshme për synimet, përmbajtjet dhe metodat e mësimdhënies të edukimit për sipërmarrësi, atëherë nuk është e vështirë të përfytyrohet çfarë efektiviteti dhe cilësie do të ketë procesi. Për këtë, nevojiten trajnime sistematike të mësuesve gjatë gjithë kohës dhe që vetë ata të arrijnë në një të kuptuar të përbashkët të konceptit dhe të mësimdhënies së sipërmarrësisë. Koha nuk pret, prandaj puna duhet filluar që tani, sepse në shtator 2011 mësuesit do të përballet me një koncept dhe një lëndë kurrikulare e cila është pothuaj e panjohur për ta. Sigurisht që gjatë zbatimit të procesit në shkollë do të dalin një sërë problematikash, të cilave do t`ju jepet zgjidhje gjatë rrugës. E rëndësishme është që procesi tashmë ka nisur dhe sipërmarrësia gjeti vendin e saj në kurrikulën shkollorë të shkollave të mesme profesionale.

Të edukosh turizmin

Prof. Dr. Salvatore MESSINA

Të edukosh turizmin: Është kjo sfida e mësuesve të shkollave të mesme shqiptare, të cilët besojnë tek nxënësit e tyre dhe dëshirojnë për ta një të ardhme prej profesionistësh të afirmuar, në të vetmin sektor që çdo vit do të ketë nevojë për 3 000 të punësuar të rinj në Shqipëri. Kjo, për 15 vitet e ardhshme! Dhe nëse i hedhim një vështrim Europës, nevoja për profesionistë në turizëm shkon në 270 000 për secilin vit të pesëmbëdhjetëvjeçarit në vazhdim!



Ç'do të thotë të edukosh turizmin? Do të thotë thjesht të paraqesësh burimet kulturore dhe natyrore që ka Shqipëria? Do të thotë të organizosh vizita në një nga këto atraktivitete, ndoshta në mënyre të shkujdesur dhe sipërfaqësore? Natyrisht që jo! Në të kundërt, duhet t'u shpjegohet të rinjve të sotëm se ata do të jenë klasa drejtuese e këtij vendi, i cili, pa shpirtin e shërbimit, pa mikpritjen, pa njohjen e gjuhëve të huaja, pa mirësjelljen, cilësinë, gatishmërinë, pa ndjenjën e respektit ndaj rregullave, ndaj trashëgimisë kulturore, ndaj ambientit, pa burime njerëzore të specializuara, kjo trashëgimi, sado e rëndësishme qoftë, nuk mund të prodhojë punësim. Do të thotë t'i mësosh çdo student të ta shohë Shqipërinë edhe me sytë e një qytetari europian dhe të dallojë çfarë mund dhe duhet ndryshuar.

Universiteti Europian për Turizmin është i gatshëm të bashkëpunojë me të gjitha shkollat e mesme të Shqipërisë për të arritur këto synime: pedagogët tanë janë të gatshëm të marrin pjesë pa asnjë detyrim në takimet që çdo shkollë do të programojë, për t'i afruar të rinjtë shqiptarë me turizmin.



Cilësia e mësimdhënies

Në literaturën pedagogjike apo didaktike ka përcaktime të shumta e të larmishme, të cilat natyrisht konvergojnë në shumë pika rreth përmbajtjes së tyre. Artikulli është një nga alternativat e përcaktimit të cilësisë së mësimdhënies jo në formën e një përkufizimi, por në formën e një strukture të përbërë nga elementë të cilët përbëjnë tre dimensione dhe një sërë indikatorësh.

I. Kuptimi i cilësisë së mësimdhënies

Të gjithë aktorët e përfshirë në një formë apo në një tjetër në fushën e edukimit, qofshin ato ofruar, apo përfitues të mësimdhënies janë shumë të interesuar për cilësinë e mësimdhënies, si një nga faktorët kyç në aftësimin për jetën të fëmijëve tanë. Në strukturën tonë të sistemit të edukimit funksionojnë dy institucione aktuale që janë të ngarkuar të monitorojnë dhe të vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies - Inspektoriati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar në nivel kombëtar dhe Drejtoria e Shkollës në nivel shkollë, të cilat përbëjnë dy lloj vlerësimesh : Vlerësimin e jashtëm dhe vlerësimin e brendshëm.

Po çfarë nënkupton, apo çfarë përfshihet në togfjalëshin “cilësia e mësimdhënies”?

Në literaturën pedagogjike apo didaktike ka përcaktime të shumta e të larmishme, të cilat natyrisht konvergojnë në shumë pika rreth përmbajtjes së tyre. Më poshtë është paraqitur një nga alternativat e përcaktimit të cilësisë së mësimdhënies jo në formën e një përkufizimi, por në formën e një strukture të përbërë nga elementë të cilët përbëjnë tre dimensione dhe një sërë indikatorësh.

Kjo strukturë mund të konsiderohet nga monitoruesit dhe vlerësuesit e mësimdhënies për të përcaktuar nivelin e cilësisë së mësimdhënies të ofruar nga një apo më shumë mësues, në një apo më shumë klasa, në një shkollë apo në shumë shkolla, pavarësisht nga shtrirja gjeografike e tyre.

Elementët e cilësisë së mësimdhënies

Dimensioni 1 - Cilësia intelektuale

Njohuritë e thella.

Njohuritë konsiderohen të thella kur ata rrokin ide qendrore apo koncepte të një teme të caktuar, të një lënde apo grup lëndësh, si edhe kur njohuritë gjykojnë se janë kruciale për temën, lëndën apo grupin e lëndëve. Njohuritë e thella janë evidente kur mësuesi, apo edhe nxënësi zotërojnë informacion, arsytim apo argumente që i adresohen pikës qendrore apo kompleksiteti të një koncepti apo ideje kyç, ose kur ndërveprimet komplekse relative vërtetojnë konceptet e tjera kryesore. E thënë ndryshe, njohuritë e thella nënkuptojnë sa përmbajtje është shpalosur në një mësim.

Arsytimi i thellë.

Arsytimi i thellë është i dukshëm kur nxënësit demonstrojnë zotërimin nga ana e tyre të koncepteve apo ideve kryesore. Nxënësit demonstrojnë arsytim të thellë kur ata eksplorojnë marrëdhëniet, zgjidhin problemet, konstruktajnë shpjegime dhe nxjerrin konkluzione në mënyrë sistematike, të integruar apo komplekse. Arsyetimi i thellë, me fjalë të tjera, është demonstrimi i të nxënësve nga ana e nxënësve.

Njohuritë problematike

Njohuritë konsiderohen problematike kur ato përfshijnë një arsytim të njohurive jo si një strukturë informacioni e pandryshuar, por më tepër si një strukturë shoqërisht e ndërtuar dhe për këtë arsye është subjekt i influencave dhe implikimeve politike, sociale dhe kulturore. Për më tepër, krahasimi apo ndoshta edhe konfliktimi i formave të njohurive, prezantohen dhe njihen si pyetje të hapura të konstruktura. P.sh. kur flasim për entitetin “familje”, njerëz të ndryshëm nënkuptojnë gjëra të ndryshme -

Nazmi Xhomara - IZHA

një, dy ose më shumë prindër; shumë fëmijë ose asnjë; familje e madhe apo familje e vogël, etj. Pra nocioni i familjes varet nga konteksti dhe rrethanat.

Të menduarit e rendit të lartë

Të menduarit e rendit të lartë kërkon nga nxënësit të manipulojnë informacionin dhe idetë në mënyra që transformojnë idetë dhe implikimet e tyre. Ky transformim ndodh kur nxënësit kombinonë fakte dhe ide për të sintetizuar, për të përgjithësuar, për të shpjeguar, për të ndërtuar hipoteza, si edhe për të arritur apo interpretuar konkluzione të caktuara. Manipulimi i informacionit dhe ideve nëpërmjet këtyre proceseve i lejon nxënësit të zgjidhin probleme dhe të krijojnë kuptime dhe arsytime të reja rreth tyre. Kur nxënësit demonstrojnë të menduarit e rendit të lartë, ata gjithashtu gjenerojnë koncepte, ide dhe produkte të paparashikuara, të cilat mund ta adresojnë të mësuarit në drejtime të reja. Megjithatë ekzistojnë mundësi për t'u përfshirë në të menduarit e rendit të lartë, kjo nuk do të thotë që këtë kusht e plotësojnë vetëm nxënësit që zotërojnë arsytimin e thellë.

Metagjuha

Mësimet, në të cilat përdoret metagjuha, karakterizohen nga nivel i lartë i të folurit rreth gjuhës dhe rreth teksteve të ushtrimeve. Mësuesit ose nxënësit në mënyrë të vazhdueshme, shprehin vëmendje ndaj aspekteve të veçanta të teksteve, si fjalëve, figurave dhe simboleve. Kjo ndodh në një pikë kyçe të mësimt, ose kur nxënësit hasin vështirësi në interpretim. Diskutime të tilla shpesh fokusohen në nxjerrjen në pah të ndryshimeve midis fjalive, tipeve të teksteve, diskutimeve, si edhe prezantimeve të tjera simbolike. Terminologjia speciale e grup lëndëve dhe e lëndëve në vetvete nuk është metagjuhë, në qoftë se përdorimi i saj nuk shpjegohet me terma jo specialë. Sistemet e simboleve operojnë si forma të gjuhës kur ata strukturojnë mendimin. Gjuha rreth tyre, ose komentet mbi to, se si funksionojnë këto sisteme simbolike, mund të konsiderohen metagjuhë.

Komunikimi substancial

Në klasat me nivel të lartë të komunikimit të pavarur ekziston një ndërveprim substancial rreth përmbajtjes së mësimt. Klasat me komunikim të lartë substancial kanë tre karakteristika :

- Ekziston një ndërveprim **substancial**
- Komunikimi fokusohet në **substancën** e mësimt
- Ndërveprimi është reciprok

Ky element identifikon cilësinë e komunikimit gojor, të shkruar apo simbolik; cilësi e kërkuar për të promovuar arsytimin koherent bashkëveprues.

Komunikimi substancial i inkurajon nxënësit të gjenerojnë pyetje rreth temës për kërkim dhe diskutim dhe i përdor ato si bazë për zhvillimin e mësimt.

DIMENSIONI 2. - Mjedisi cilësor i të mësuarit

Kriteret eksplicite të cilësisë

Kriteret e cilësisë me eksplicitet të lartë identifikohen nga formulimet e vazhdueshme, të detajuara dhe specifike rreth cilësisë së mësimdhënies të kërkuar nga nxënësit. Kriteri eksplicit i cilësisë, shndërrohet në pikë reference kur mësuesi dhe nxënësit e përdorin kriterin për të zhvilluar dhe kontrolluar punën e tyre apo punën e të tjerëve. Duhet të ofrohen ekzemplarë të plotësuar, kampione pune apo modele që ilustronë performancën e lartë cilësore të nxënësve të bazuar në kriteret. Këto ekzemplarë mund të merren nga nxënësit e viteve të kaluara, ose nga burime të tjera.

Angazhimi

Angazhimi i lartë identifikohet nga sjelljet mbi detyrën që sinjalizon një investim serioz në punën në klasë. Këto sjellje përfshijnë interes dhe vëmendje substanciale, fokusim individual në punë, shpalosje të entuziazmit për punë dhe marrjen seriozisht

të punës. Angazhimi i lartë gjithashtu mund të vihet në dukje kur nxënësit marrin iniciativën të ngrenë pyetje, të kontribuojnë në detyrat në grup, si edhe të ndihmojnë të tjerët. Megjithatë angazhimit serioz shpesh i mungojnë formate demonstruese.

Pritjet e larta

Pritjet konsiderohen të larta kur mësuesit ose nxënësit komunikojnë pritjen që të gjithë nxënësit e klasës mund të nxënë njohuri dhe aftësi që janë sfiduese për to. Nxënësit inkurajohen dhe falënderohen kur ata ndërmarrin rrisqe konceptuale, apo edhe të tjera në procesin e të nxënësve. Pritjet janë gjithashtu të larta kur nga nxënësit e të gjitha niveleve pritjet dhe tentohet të zotërojnë punën sfiduese, kur sfida është intelektuale, fizike apo e bazuar në performancë. Shkalla kodifikuese për këtë element thekson që elementi i pritjeve të larta nuk ka të bëjë me numrin e nxënësve që marrin pjesë në mësim, por me numrin e nxënësve që përfshihen në **detyra sfiduese**.

Mbështetja sociale

Klasat që karakterizohen nga një mbështetje e lartë sociale për të nxënësit e nxënësve, inkurajojnë të gjithë nxënësit të marrin pjesë dhe të rrezikojnë dështimin fillestar në një klimë të karakterizuar nga respekti reciprok. Klasat me mbështetje sociale të lartë karakterizohen nga sjellje të mësuesve dhe të nxënësve, komente dhe veprime që inkurajojnë dhe vlerësojnë përpjekjet, pjesëmarrjen dhe shprehjen e pikëpamjeve individuale në vijim të të nxënësve. Nëse një mosmarrëveshje ose konflikt ndodh në klasë, ai zgjidhet në mënyrë konstruktive për të gjithë ata që përfshihen në të. Mësuesi ka përgjegjësinë për drejtimin e tonit në klasë duke krijuar dhe ruajtur një mjedis ku mbizotëron respekti reciprok.

Vetë-rregullimi i nxënësit

Vetë-rregullimi i lartë është evident kur mësimi procedon pa ndërprerje dhe kur nxënësit demonstrojnë autonomi dhe iniciativë në marrëdhënie me sjelljet e tyre në mënyrë që e lejojnë klasën të përparojnë me të nxënësit. Virtualisht nuk shpenzohet kohë, ose nuk ka nevojë të shpenzohet kohë për sjelljet e indisiplinuara të nxënësve apo për lëvizjet e tyre në klasë. Veprimtaritë e zhvilluara në klasë janë të qëllimshme dhe interesante, me objektiva të qarta, që nxënësit i perceptojnë të vlefshme.

Udhëheqja apo drejtimi i nxënësve

Klasat me udhëheqje, apo drejtim të lartë të nxënësve karakterizohen nga nxënës që ushtrojnë kontroll mbi një apo më shumë aspekte të mëposhtme të mësim:

- Zgjedhja e veprimtarive,
- Koha e shpenzuar në veprimtari,
- Hapi i mësim,
- Kriteret mbi të cilat do të bëhet vlerësimi.

Kur nxënësit marrin përgjegjësi për veprimtaritë në të cilat ata përfshihen, apo për cilësinë e kryerjes së tyre, këto veprimtari janë realisht **me në qendër nxënësin**, p.sh. puna në grupe, kërkimi individual, projekte praktike të hulumtimit, etj. Mësuesit, do të kenë synime të ndryshme për të ofruar mundësi për nxënësit, në mënyrë që ata të ushtrojnë kontroll mbi këto katër aspekte në varësi të lëndës që japin mësim, apo të stadi të nxënësve të tyre.

DIMENSIONI 3. Kuptimi

Njohuri të fituara

Njohuri të larta të fituara janë të dukshme kur mësimi ju ofron nxënësve mundësi të realizojnë lidhje midis njohurive të tyre dhe eksperiencës nga njëra anë dhe substancës së mësim nga ana tjetër. Njohuritë e fituara mund të përfshijnë njohuri të mëparshme shkollë, njohuri të fituara jashtë shkollës, njohuri kulturore, eksperiencë personale dhe njohuri nga media apo nga kultura popullore. Fokusi kryesor i këtij elementi është identifikimi nëse njohuritë e fituara më parë të nxënësve në klasë vlerësohen apo lidhen me substancën e mësim.

Njohuri kulturore

Njohuri kulturore vlerësohen të larta kur vihet re arsytim, vlerësim dhe pranim i traditës, besimeve, aftësive, njohurive, gjuhëve, praktikave dhe protokolleve të grupeve sociale të ndryshme. Njohuritë kulturore konsiderohen të larta kur gjatë

mësimi çmohen dhe vlerësohen pohimet e grupeve të ndryshme sociale në një mënyrë autentike, të detajuar dhe të thellë. Grupet e ndryshme sociale identifikohen në lidhje me kulturën dominuese dhe klasifikohen mbështetur në karakteristika të tilla si: statusi social -ekonomik, gjinia, etnia, raca, mosha, paaftësia apo besimi. Duke përmbledhur mund të themi se elementi i njohurive kulturore përmbledh respektin dhe vlerësimin e njohurive të grupeve të ndryshme sociale.

Integrimi i njohurive

Integrimi i lartë i njohurive është i identifikueshëm kur në klasë realizohen lidhje logjike midis temave të ndryshme apo lëndëve të ndryshme. P.sh. kur nxënësit për të trajtuar një çështje apo për të zgjidhur një problem aplikojnë njohuri nga shumë tema, apo lëndë mësimore; në këtë rast themi se integrimi i njohurive është i nivelit të lartë. Integrimi i njohurive, arsytimi dhe aftësitë nga lëndët e tjera do të përforcojnë të nxënësit, vetëm nëse ai i kontribuon arsytimit të thellë të koncepteve kryesore.

Gjithëpërfshirja

Gjithëpërfshirja e lartë është evidente kur të gjithë nxënësit në klasë, nga të gjitha kulturat apo origjinat, marrin pjesë në detyrat e shtruara, si edhe kur kontributet e tyre merren seriozisht dhe vlerësohen. Gjithëpërfshirja e lartë identifikohet kur klasa është e çliruar nga format negative të paragjykitimit dhe diskriminimit dhe për këtë arsye, të gjithë individët, pavarësisht nga origjina e tyre, ndjehen të inkurajuar të marrin pjesë plotësisht në mësim. Elementi i gjithëpërfshirjes i referohet specifikisht faktit, ku të gjithë nxënësit çmohen dhe vlerësohen, pavarësisht grupit social ku ata bëjnë pjesë.

Bashkëlidhja



Bashkëlidhja e lartë është e dukshme kur të nxënësit merr vlerë dhe kuptim përtej klasës dhe shkollës. Mësimet shpalsin bashkëlidhje të lartë nëpërmjet adresimit të një problemi publik, një eksperience aktuale apo situatave në jetë, me të cilat do të ndeshen nxënësit. Bashkëlidhja e lartë gjithashtu vihet re kur ka tentativa për të ndërvepruar me një audiencë përtej klasës, duke ju komunikuar njohuri të tjerëve, përfshirë edhe brenda shkollës, duke advokuar zgjidhje për probleme sociale, duke ofruar asistencë njerëzve, apo duke krijuar performanca, ose produkte dhe duke eksploruar vlerat e tyre utilitare ose estetike.

Rrëfimi ose narracioni

Përdorimi i rrëfimit apo narracionit konsiderohet në nivel të lartë kur njohuritë, konceptet, nocionet shkruhen, tregohen, lexohen, vëzhgohen, apo dëgjohen për të ndihmuar ilustrimin, apo sjelljen në jetë të njohurive, për të cilat nxënësit janë të angazhuar në klasë. Rrëfimet, ose narracionet përfshijnë historitë personale, biografite, të dhënat historike, rastet e studimeve, tekstet letrare, kulturore, si edhe performancat. Rrëfimi nuk rrit rëndësinë nëse historitë e përdorura nuk janë të lidhura me substancën e mësim, ose janë jo produktive në termat e të nxënësit të nxënësve. Rrëfimi mund të konsiderohet i lartë vetëm nëse aplikohet një pjesë në mësim dhe vetëm për sa kohë kjo pjesë rrit rëndësinë e substancës së mësim. Mësimet mund të përdorin rrëfimin si **përmbajtje**, kur nxënësit lexojnë ose dëgjojnë pjesë, ose si **proces**, kur nxënësit shkruajnë ose tregojnë pjesë të tilla.

Studim teksti “Kulla” e Anton Pashkut

Nga Vjollca SPAHO

Mësimdhënie e mirë është ajo që përpiqet ta shikojë mësimdhënien dhe të nxënit nga perspektiva e nxënësit. Ajo i ndihmon nxënësit të kuptojnë kontekstin në të cilin ndodhen. Nga ana tjetër, kjo mësimdhënie i ndihmon të kuptojnë përse është duke u shpjeguar materiali letrar dhe përse ata duhet ta mësojnë atë.

Hyrje

Mësimdhënia e letërsisë bëhet e vështirë kur ke të bësh me një grup nxënësish, të cilët mjaftohen me subjektin (e veprës letrare) dhe kur libri i mirë nis e “shkatërrohet” ngaqë mësuesi shumë shpejt tregon fundin tij.

Si mësuese letërsie vazhdimisht kam ndjerë se formimi letrar i nxënësve arrihet sidomos në orën e komentit letrar i cili është një nga aktivitetet mësimore më të rëndësishme brenda orës së mësimt, që siguron suksesin për të arritur në fazat e tjera si analiza, krahasimi, mendimi kritik etj. Përvojat interpretuese të një teksti artistik ndryshojnë me kohën, duke reflektuar interpretime të ndryshme; secili studim teksti në orën ekomentit të letërsisë tenton të gjejë të meta tek ato të mëparshmet, të cilat në fakt përfaqësojnë një model interpretimi.

“Teksti, sipas Roland Barthes, është etimologjikisht një teksti i thurur (nga latinishtja *texere*); është një thurje me tekstet dhe përdorimet e mëparshme të gjuhës, që mbart së brendshmi jehonën e tyre; një thurje e referencave dhe ngjarjeve historike, një thurje e lojës së gjuhës. Një tekst nuk është, nuk mund të jetë një ‘diçka’; një tekst është një proces. Teoria Letrare futet në thellësinë, kompleksitetin dhe papërcaktueshmërinë e kësaj thurje deri në zbulimin jo vetëm të gjithë implikimeve të shumëllojshmërisë, por edhe të kontradiktave paevitueshmërisht të brendshmet në to.

Model

Le të përpiqemi të japim një model të studimit të tekstit “Kulla” të A. Pashkut.

Teksti i tregimit “Kulla” është i përbërë tërësisht nga një sistem figuracioni ku lidhen figurat themelore me situatat dhe stilemat simbolike.

Deshifrimi i tyre nuk mund të prodhojë vetëm një ide themelore, por idetë themelore dhe vizionet artistike dalin në ndërlidhjet e figurave kryesore.

Në një orë të studimit të fragmentit, që merret për interpretim, kërkohet një lexim paraprak jo vetëm i fragmentit, por edhe të gjithë veprës nga nxënësit.

Mësuesi i letërsisë duhet t’i kushtojë rëndësi të madhe parapërgatitjes së nxënësve në orën paraardhëse, madje, është shumë e rëndësishme, që vepra të jepet për lexim në pushimet e vitit shkollor. Gjithashtu mësuesi duhet t’i paraprijë orës së studimit të tekstit me një pyetësor që ju ofron nxënësve për të realizuar sa më mirë orën pasardhëse. P.sh.

- Ç’përfaqëson kulla? - Shtëpi e vjetër banimi me një arkitekturë

tepër të veçantë, me dritare të vogla, për t’u mbrojtur nga hasmi.

- Në cilat zona gjeografike i gjejmë ato? - Janë tipike për Shqipërinë e Veriut.

- A kanë luajtur rol zakonet dhe doket tona tradicionale,

që për kullat të ketë një shenjë të veçantë respekti dhe adhurimi?

Po. Ato kanë qenë jo vetëm objekte banimi, por edhe pjesë e krenarisë

së malësorëve, përfaqësuese të identitetit të tyre.

- Duke qenë të tilla, ku pasqyrohet në tregim adhurimi për kullën dhe brenga për humbjen e saj

- Brenga se Kulla mund të rrënohet është brengë e dy brezave, njërit që shkon dhe tjetrit që vjen. Kulla, në tregimin e Pashkut, nuk është më një ngrehinë muresh, por historia, kujtimi për të, vetëdija për qëndresën kulturore dhe brenga për rrezikun e saj

Kjo është dhënë në një sintezë figurative, që në fillim të tregimit.

“Dje e varrosëm plakën, kurse tash jam i etur; gotën e ujit nuk e shoh në komodinë. S’kam dritë; qiriu është shkrirë në shandanin e vogël të ergjendë, të cilin e kam gjetur para shumë vitesh në ahrin e lënë shkret, ku edhe tash gjendet njëfarë harku me kordhëz të këputur që rri mbi një grumbullim plehu”

Brenga e plakës së vdekur do të kthehet në vetëdije për rrezikun e rrënimit të kullës, simbolike e qëndresës, e cila është sulmuar nga mali.

Tregimi zhvillohet me rimarrje të situatës së personazhit-rrëfimtari

- Cila është situatë themelore e tregimit “Kulla”.

Ajo krijohet në dialogun e plakës me kasapin, që nis si dialog mbi ekzistencën, vijon si dialog i viktimës me xhelatin dhe mbaron me dënuesje të plakës” duke lidhur shaminë e zezë pa asnjë larë”

Krijohet natyrshëm çifti i parë i të kundërtave. Le të përpiqemi të kuptojmë simbolikën që mbartin.

Plaka është e vjetër r- sinonimi për të mund të jetë,”e lashtë”

- Plaka i përket brezit që ka shkuar në varr, kurse botëkuptimi dhe përvoja e këtij brezi jetojnë dhe deshifrohen vetëm në vetëdijen e brezit të mbetur. Kjo mënyrë krijohet në tregim me kalime retrospektive, duke u nisur nga një gjendje e tashme, duke përfshirë kujtime personale. Duke e intensifikuar këtë lidhje emocionalisht, autori ka arritur të thotë se lidhjet ndërmjet brezave janë të





pashkëputshme dhe se ato krijojnë identitetin kulturor si trashëgimi e një populli.

Kasapi del herë pas herë në dialog me një thikë me tëh të prehtë e vezulluese- "sinonimi i vrasësit".

"E ç'na pat mbetur tjetër, or kasap" pat rënkuar plaka.
 "S'kemi, madje, asnjë korriqe drith..."
 "Kush na vodhi e ta shiti bardhioken, or kasap?... Sall ajo...sall ajo na ka pas mbetun pas shpirtit

Në këtë zi Kasapi përgjigjet;

"Keni.. ja, keni sytë, keni veshtë, keni, madje edhe gjuhën!...
 Keni buzët, keni duart, keni këmbët, keni, madje edhe zemër!..keni mandej zorrët, keni, besa, edhe mushkëritë
 Keni ju keni me se të jetoni..."

Shikoni përgjigjen e Kasapit. Me fjali të shkurtra, të nisura me foljen "keni" dhe të ndjekura me nga një emër gjymtyrësh, finalizohet mendimi me foljen "Hani" që krijon efektin e makabër.

Mandej kasapi ngriti një teknologji si ta hajë veten kolektivi i plakës, ku sytë duhet të hahen në fillim.

Pse?

- Për të mos parë tmerrin, kurse koka në fund, për të mbaruar të gjitha.

Po pastaj ai kalon në një rrënim kulturor të fshirjes së kujtesës me rrënimin e kullës

Kurse plaka mbrohet:

"Po ti nuk di ç'janë ato gërmadha, ti nuk di se në ato gërmadha gjendet një këmborë".

Kemi dy kultura

Kasapi = kultura e huaj shkatërrimtare.

Plaka = kultura vendase që ruan shenjat e veta reale

Këtu kemi simbolizmin e Pashkut

Duke synuar jo vetëm një historizim, por dhe aktualizim të tekstit, arrijmë prej këtij raporti në një prej motiveve të fshehura të tregimit:

- Ideologjia shoviniste shfarosëse që ka përndjekur për më tepër se një shekull popullsinë shqiptare të Kosovës. Në mënyrë diskrete drama kolektive, jepet përmes dramës individuale. Në fakt, ideologji të kësaj forme gjejmë edhe përtej kësaj drame kombëtare që luhet në Ballkan, kështu që mesazhi bëhet më i gjerë, më universal.

Tregimi vazhdon me rimarrje të situatës së personazhit-

rrëfimtari.

"Më zgjoi etja dhe ku ndjehet vetëm çuçleni i kroit dhe fillimi i natës, që përvidhet nëpër frengji. Më duket se është afruar agu. Errësira nuk është e dendur si më parë".

Gjithë tmerrin e rijetuar si kujtim personal dhe si përvojë brezash, është bërë në vetmi dhe në natë, kurse një fije shprese vjen me agimin. Është pjesëtari i brezit që merr barrën e trashëgimisë kulturore dhe jetësore me të gjithë peshën e saj. Ideja e qëndresës kulturore është më e fuqishme sesa qëndresa fizike e cila është ndërtuar ngadalë dhe fuqishëm në këtë tregim. Kjo është qëndresa e kujtesës, e trashëgimisë, e shpirtit të një populli i cili nuk do të priset as përpara turrave rrënimtare të të huajve. Vetëm shpirti shpirti s'mund të vidhet.

Tani mund të themi se tema është: Fat i ekzistencës dhe i kulturës shqipe në Ballkan

Detyrë për nxënësit:

Grupi A - Gjeni pikaty e takimit me romanin "I huaji" i Kamysë .

Grupi B - Gjeni çiftet që japin të kundërtat brenda tregimit.

Krijoni një skemë të simboleve që keni ndeshur gjatë tregimit dhe intepretoni atë.

Kasapi -	Plaka
Pylli -	Kulla
Gërmadha -	Këmbora

Veprimtari përmbyllëse: Nxënësve u jepet detyrë shtëpie:

a) të shkruajnë një ese argumentuese me temë:

"Analizo format e mendimit filozofik ekzistencialist në tregimin e A. Pashkut, përmes dy figurave bazë, simboli dhe metonimia"

b) Gjeni lidhjet kuptimore ndërmjet Tymit dhe Kullës. Përse pas Kullës Tymit bëhet simboli rëndësishëm i tregimit?

Ç'tregon një kullë që nxjerr tym?

Litteratura:

1. Hamiti S. "Poetika Shqipe" maj 2010
2. Barthes R. "Kënaqësia e tekstit"
3. Kristeva J. "Teoria bashkëkohore e letërsisë"



Fëmijët parashkollor në qendër të kujdesit

Fëmijët përfshijnë një botë të madhe sociale dhe edukative si dhe një detyrim të madh edukativ dhe prindëror. Kjo, sepse fëmija fokuson dhe "regjistron" sjellje dhe qëndrime të ndryshme duke filluar nga ato të bashkëmoshatarëve, të prindërve dhe familjarëve brenda shtëpisë dhe tek edukatorët e tyre. Fëmijët 6 vjeçar, për shembull, bëhen të aftë në përshtatje me këto sjellje dhe komunikime, ata bëhen aktiv dhe, midis të gjithë këtyre aktorëve dhe faktorëve, lind një bashkëpunim i nevojshëm praktik.

Padyshim, që aftësitë dhe mendja e tyre rritet dhe përpunohet ngadalë, por çdo ditë tek ata pasqyrohen gjurmë dhe zhvillime të reja, realiteti dhe shoqëria, familja, edukatorët lënë gjurmët e veprimit dhe punës së tyre te këta fëmijë. Siç pohojnë studiuesit, zhvillimet nuk realizohen në mënyrë të menjëhershme, ato rriten shkallë-shkallë, sidomos në vitet ndërmjet moshës 3 dhe 5 - vjeçare dhe marrin hove të mëdha në vitet e mëvonshme. Madje zhvillimi social i parashkollorëve është tepër mbresëlënës dhe të entuziazmon kur i sheh në reagimet dhe veprimet e tyre. Pra zhvillimi social edukativ i fëmijës, si çdo aspekt tjetër i zhvillimit të parashkollorëve, kushtëzohet dhe ndërvarret nga konteksti ku ai ndodhet dhe rritet. Në të gjithë këtë vlerë sociale edukative, merr rëndësi të veçantë edhe familja, praktika edukative që përdorin prindërit me fëmijët e tyre. Çdo veprim i prindërve nuk kalon pa u vënë re nga fëmijët, kështu që tek ata ndizet interesi dhe kureshtja, lindin pyetje dhe ndjenja të habitshme të cilat doemos kërkojnë përgjigje të drejta, jo të ndërlikuara dhe thjeshtë moralizuese, por veprime dhe bashkëbisedime të sakta, të menduara dhe të shprehura thjeshtë e qartë.

Prindërit i trajtojnë fëmijët dhe detyrimet ndaj tyre në mënyra të ndryshme, por siç mësojmë nga sociologët, katër stilet e rritjes së fëmijëve janë përcaktuar qartë si autoritar absolut, indiferent, liberal (lejues), autoritativ. Prindërit autoritar absolut janë tepër kërkues, ushtrojnë një kontroll të fortë mbi sjelljen e tyre. Fëmijët e prindërve autoritar shqetësohen me lehtësi dhe manifestojnë sjellje të paqëndrueshme, shprehin agresivitet dhe kryejnë veprime që shqetësojnë familjen, mjedisin dhe edukatorët e tyre. Natyrisht studiuesit e përcaktojnë këtë lloj edukimi si stil gjysmak, i cili jo vetëm që nuk nxit zhvillimin social edukativ, por i largojnë këta fëmijë nga pjesëmarrja aktive në shoqëri, ata mbylleen në vetvete dhe janë vazhdimisht të acaruar. Ndërsa, siç pohojnë studiuesit, prindërit e fëmijëve liberal janë të dashur dhe emocionalisht të ndjeshëm ndaj vendosin shumë pak kufizime në sjelljen e fëmijëve të tyre. Kujdesi



Prindërit duhet të ecin mbi një rrugë të menduar mirë dhe duke u këshilluar me literaturat shkollore, me specialistë psikologë dhe me eksperiencë që janë të shumta dhe të bollshme për edukimin e mirë social të një fëmije. Pedagogjia dhe studiuesit këshillojnë që prindërit duhet të jenë gjithmonë mbrojtës për fëmijët e tyre, por jo ta teprojnë. Në se prindërit arrijnë përfundimisht këtë ekuilibër kjo ndihmon jashtëzakonisht në formimin e një gjendje mendore dhe fizike mjaft të mirë dhe të ekuilibruar të fëmijës, ata bëhen të dashur, të ditur dhe të vlefshëm. Këtë detyrë edukatoreve të kopshteve që veprimet e çastit të jenë të vetëdijshme se, këto qëndrime që ndryshojnë me shpejtësi janë një pjesë normale e zhvillimit. Fëmijët në shoqërinë moderne, kopshtet dhe mjedisi për rreth i ofrojnë fëmijës një grup sfidash të reja që duhet të baras peshohen me ato në shtëpi. Këtu forcohet shumë bashkëveprimi me të rriturit. Në këtë fazë fëmijët kërkojnë konfirmim nga prindërit dhe të rriturit e tjerë, që iniciativa e tyre të praktikohet.

Nga Fran GJOKA, DAR Lezhë
për fëmijët ka efektet më pozitive në zhvillimin e hershëm social. Fëmijët e këtyre prindërve janë më kureshtar, më me besim në vetvete, më të pavarur. Gjatë viteve të tij parashkollorët lëvizin mjaft lirisht brenda dhe jashtë tri botëve që përkojnë pjesërisht me njëra - tjetrën: shtëpi - shkollë dhe fqinjësia. Këtu, prindërit mbeten të rëndësishëm, por këto grup moshë harxhojnë sasi kohe në rritje me më të rriturit,

duke qenë vëzhgues të sinqertë apo ndonjë rast mbartës të veprimeve negative nga të rriturit. Psikologët kanë zbuluar se me pjekurinë e fëmijëve ndryshon edhe kuptimi i shoqërisë për ta. Deimen Damon (1977) ka parashikuar me saktësi tre nivele të shoqërisë, por miqësitë mund të fillojnë e të marrin fund shpejt bazuar në veprimet e dashamirësisë, ose dashakeqësisë (Bardhyl Musai 1999). U del detyrë edukatoreve të kopshteve që veprimet e çastit të jenë të vetëdijshme se, këto qëndrime që ndryshojnë me shpejtësi janë një pjesë normale e zhvillimit. Fëmijët në shoqërinë moderne, kopshtet dhe mjedisi për rreth i ofrojnë fëmijës një grup sfidash të reja që duhet të baras peshohen me ato në shtëpi. Këtu forcohet shumë bashkëveprimi me të rriturit. Në këtë fazë fëmijët kërkojnë konfirmim nga prindërit dhe të rriturit e tjerë, që iniciativa e tyre të praktikohet.

Prindërit duhet të ecin mbi një rrugë të menduar mirë dhe duke u këshilluar me literaturat shkollore, me specialistë psikologë dhe me eksperiencë që janë të shumta dhe të bollshme për edukimin e mirë social të një fëmije. Pedagogjia dhe studiuesit këshillojnë që prindërit duhet të jenë gjithmonë mbrojtës për fëmijët e tyre, por jo ta teprojnë. Në se prindërit arrijnë përfundimisht këtë ekuilibër kjo ndihmon jashtëzakonisht në formimin e një gjendje mendore dhe fizike mjaft të mirë dhe të ekuilibruar të fëmijës, ata bëhen të dashur, të ditur dhe të vlefshëm. Këtë detyrë

edukatoreve të kopshteve e bëjnë pa u lodhur, pa zhurme, me seriozitet me përkushtim. Janë këta breza edukatoresh që fëmijët gjejnë ngrohtësinë, mirësinë dhe humanizmin. Nuk rrimë dot pa përmendur edukatorët Zegjina Hoxha, Elisabeta Gjoka, Drita Zyberi, Pertefe Saliu, Prenda Pali, Dila Nikolli, Vera Lleshi, Marie Pjetri, Mrika Gjini, Gjyljana Hila, Sulltana Curri, Flora Zefi, Drande Pjetri, Hana Nika etj....Janë me dhjetëra edukatore kopshtesh, që vazhdojnë të punojnë me përkushtim në profesionin e tyre, që të ngelin në mendje edhe të ngjallin respekt për punën që bëjnë, për përpjekjet dhe përkushtimin që tregojnë për vendet që kanë në shoqëri, për misionin e tyre të madh dhe fisnik.

Nxënësi si person

Besoj se detyra e parë e mësuesit nuk është transmetimi i njohurive, shumë e rëndësishme, por krijimi i një marrëdhënieje personale me çdo nxënës, në mënyrë që ta ndihmojë të nxjerrë në pah karakteristikat e veçanta të personit të tij.

Mësimdhënia është marrëdhënie midis personit të çdo mësuesi dhe personit të çdo nxënësi në veçanti. Kjo se klasa është një shoqëri personash dhe jo një grup kompakt uniform. Besoj se detyra e parë e mësuesit nuk është transmetimi i njohurive, shumë e rëndësishme, por krijimi i një marrëdhënieje personale me çdo nxënës, në mënyrë që ta ndihmojë të nxjerrë në pah karakteristikat e veçanta të personit të tij. Në këtë mënyrë do të japim te fëmijët stimuj të brendshëm për mësim që do t'i mbartin gjatë gjithë jetës së tyre. Qëllimi është të duan mësimin dhe ta kërkojnë në gjithë jetën e tyre, akoma dhe kur do kenë mbaruar vitet e shkollës. Në çdo marrëdhënie rolet e marrësit dhe të dhënësit të mesazheve janë alternative. Kurrë, në një marrëdhënie nuk është një palë gjithnjë dhënësi dhe tjetra palë marrësi. Vallë, a e kemi konceptuar ndonjëherë këtë gjë gjatë mnësimdhënies? Kërkojmë nga nxënësit të na dëgjojnë me vëmendje dhe nevríkosemi kur kjo gjë nuk ndodh. Kemi menduar ndonjëherë nëse ne i dëgjojmë? Nëse i japim mundësinë të shprehen? Sepse ndoshta me gojë ua kërkojmë këtë gjë, por duhet se pari të kemi krijuar një lidhje lirie, dashurie dhe respekti, në mënyrë që nxënësi të ndiejë siguri dhe të shprehet. Vetë marrëdhënia është dëgjim. Por shumë herë, për arsye që të mbulojmë lëndën gjatë orës së mësimin, fillojmë një monolog të zgjatur, ku nuk "dëgjojmë" as mesazhet pa fjalë që na dërgojnë nxënësit nëpërmjet zhurmës, indiferencës, mohimit.

Lejomëni të referoj një eksperiencë që kisha vjet kur jepja mësim në një gjimnaz në Kretë. Isha mësuesja kujdestare në klasën e dytë ku shumica e nxënësve ishin të lëvizshëm dhe në nivel të ulët. Para orës së gjuhës greke të lashtë, nxënësit bënëin matematikë me një mësuese të re e cila nuk kishte aritur të lidhej me nxënësit për arsye të mungesës së përvojës. Kështu ishte zhvilluar konkurrenca dhe dyshimi midis tyre. Një herë, kur hyra në klasë për mësim, i gjeta nxënësit që ndienin padrejtësi nga mësuesja, në një gjendje të tensionuar dhe të zemëruar. Kisha dy zgjidhje. Të vendos qetësi në klasë dhe të vazhdoja mësimin, meqënëse nuk kisha mundësinë të humbas orë, pasi ishte lëndë e vështirë dhe ishim pas. Ose të dëgjoja nxënësit dhe të përpiqesha t'i qetësoja ata. Zgjedha të dytën. Fillimisht, lashë fëmijët të shpreheshin lirshëm, në mënyrë që të kuptoja se çfarë ndienin dhe pastaj iu thashë: "Nuk kam të drejtën të komentojë asgjë për kolegen, kur ajo nuk është tani këtu dhe nuk mund të na thotë se si ajo e sheh gjendjen. Le të supozojmë se gjërat janë ashtu siç i përshkruani. Keni kuptuar që dhe ju mirrni pjesë tek procesi i mësimdhënies? Keni menduar që mund të keni përgjegjësi? Që keni të drejtë dhe ju vlen mësim i cilësisë së mirë dhe që duhet ta kërkonim me mënyra që kanë rezultat? Le të shohim se si mund të bëhen gjithë këto..." Vijoi një dialog ku nxënësit shprehnin kundërshtime që dalëngadalë u qetësuan, meqënëse u jepej një anë tjetër shikimi ku konceptonin se kishte të vërtetë brenda saj. Në takimin tjetër më thane: "Nuk kishim detyra mësuese, sepse nuk bëmë mësim radhën e kaluar" iu përgjigja: "Gaboni! Harruat se sa gjëra të reja mësuam se si duhet të reagojmë në një gjendje të vështirë?" Ndoshta humba një orë mësimi, por fitova në lidhjen time me fëmijët. U forcua besimi i tyre ndaj personit tim dhe mësimet e tjera vazhduan shumë më lehtë dhe u mbulua edhe humbja e orës.

Është e nevojshme të konsiderojmë çdo nxënës si person. Të zbulojmë veçantitë e tij. Talentet dhe dobësitë e tij. Në mënyrë që të përshtatim dhe kërkesat tona. Dhe këtu mund të përdor-

Anastasia LLAGU mësuese - Delvinë

ret ajo që thamë që në fillim, që shoqëritë në zonën tonë janë heterogjene duhet edhe të njohim gjendjen familjare të fëmijës, që shpesh ka rolin kryesor në sjelljen e tij. Duhet të ndihemi si dirigjentë, duhet t'i harmonizojnë tingujt e ndryshëm të çdo instrumenti. Nxënësit tanë janë instrumente të ndryshme që duhet të nxjerrim në pah. Hipokrati, ky mjek i madh, thoshte se nuk ekzistonin sëmundje, por pacientë. Nxënësi, pra, nuk është një kuptim abstrakt, por Kosta, Elena, Olsi, Besa, Arba... Si dhe përkatësisht pjesë e sistemit arsimor që shpesh kritikojmë, jemi ne. Kemi përgjegjësinë tone të madhe se nëse nxënësi do të dojë mësimin jo. Ne kemi mundësi të vendosim ngjyra te shkolla gri. Kemi mundësi të kthejmë atë që është pa fytyrë në diçka personale. Me përvojën time të vogël pashë se sa gëzoheshin fëmijët kur u rrëfeja një ngjarje të shkurtër nga jeta ime me atë që thoshim në mësim. Jo në kurriz të mësimin. Ndiem se i bëja pjesë të personit tim. Se nuk çoja mure të larta midis nesh. Në vazhdim, ndienin sigurinë të hapnin dalëngadalë dhe ata zemrën e tyre. Duke njohur botën e tyre të brendshme, mund t'i ndihmojmë shumë më mirë. Dhe mënyra më e shpejtë dhe rezultative të ketë sukses mësimdhënia, është të frymëzosh nxënësin dhe jo ta frikësosh atë. Përdor këto histori të vogla me konkluzione pozitive, gjithnjë në lidhje me mësimin. Kur shoh që fëmijët janë lodhur, sepse janë të vështira ato që u shpjegoj, ose ishin të përqëndruar në mësim për mjaft orë dhe nuk kanë më fuqi, në vend të filloj të bërtas dhe t'i qortoj që nuk më ndjekin më, filloj dhe i them një histori të vogël: "Kur isha e vogël, një herë bashkë me vëllanë tim..." Është e pabesueshme se si të ndjekin dhe ndalojnë çdo gjë që bëjnë. Qeshin, çlodhen dhe në mënyrë të natyrshme, pa mundim fillojmë përsëri mësimin. Mos t'i trembemi njohjes personale me fëmijët. Mos të jemi si shtëpi me dritare dhe dyer të mbyllura në mënyrë hermetike. Le të kuptojmë që mund të marrim nga fëmijët shumë gjëra të rëndësishme për formimin e personit tonë.

Ndoshta sa thamë më lartë duken teorike, ose të vështira në zbatim. E dimë që ekzistojnë shumë probleme në shkollë, çdo ditë në praktikë. Që të gjithë jemi njerëz me problemet tona dhe bëjmë durim. Që dhe ne do të donim të ekzistonte dikush që do të na ndihmonte në rrugën tonë të vetëdijes. Por mendoj se këto të gjitha janë një sfidë. Një sfidë që të shohim gjërat në brendësi dhe jo në sipërfaqe. Le të jenë ngacim për t'u menduar. Mund të jetë e vështirë rruga, por le të njohim të paktën qëllimin. Nuk kam për të propozuar ndonjë sistem pedagogjik. Thjesht të shfaq përgjegjësinë personale të secilit, të bëhemi persona. Të funksionojmë në lidhje me nxënësit. "**Marrëdhënia është zgjidhja e enigmës. Brenda marrëdhënies lind kurajoja dhe fuqia e zgjidhjes, akoma dhe pranimi i mos zgjidhjes. Brenda marrëdhënies zbulohesh dhe njihesh, përndryshe mbetesh gjithmonë një enigmë e pazgjidhur.**" (Aleksandër Katcianas)



PSIKO - DËSHMI 2

Artikujt “Psiko - Dëshmi” janë pjesë e realitetit tonë të përditshëm në shkolla dhe familje. Rëndësia që ne i japim një fakti apo një ndodhie në shkollë, apo jashtë saj është ndonjëherë vendimtare në realitetin psikologjik të fëmijës. Të thënurit e këtij realiteti nuk ka qëllim moralizues, por shërben si dëshmi nga ku ne shohim veten dhe të tjerët dhe nga ku marrim qëllimin e radhës, për ditën e ardhme apo për kohën e ardhme. Në çdo numër ne do t’ju sjellim tema të reja ku secila sjell një realitet me të cilin ndeshemi përditë, por reagimet për secilën prej tyre ju do t’i keni në vetveten tuaj.

Inferioriteti si frikë, apo frika si premisë inferioriteti

Në klasifikimin e përditshëm që ne u bëjmë fëmijëve, ndarjet më të mëdha janë në dy kategori: të urtët dhe të shkathët. Prirja e përgjithshme shkon drejt stimulimit të të shkathëtëve, megjithëse kjo kategori fëmijësh nuk ka aq shumë nevojë për këtë shtysë, pasi ata janë mësuar ta rrëmbejnë atë që duan dhe në momentin që e duan.

Shpeshherë ne nisemi nga rreket individuale për t’i paraprirë zhvillimit gjatë një procesi mësimor. Madje në një pjesë të mirë të rasteve kjo shkon deri aty sa ne të merremi me pjesën e dukshme duke lënë në hije të ashtuquajturat “prirjet e buta”. Pikërisht këtu nis indiferenca e cila vetë shpërthen në inferioritet dhe frikë.

Mjedisi “klasë” është vatra e ushqimit për dy konceptet psikologjike të mësipërme. Ky mjedis na jep mundësinë e vazhdueshme që ne të konstatojmë prirjet e pakëndshme të kësaj dukurie dhe më pas të mbajmë qëndrimin tonë kundrejt tyre.

Prindërit kërkojnë vazhdimisht nga mësuesit e fëmijëve të tyre që ato t’i angazhojnë dhe mësuesit ankohen vazhdimisht se nuk kanë ndihmën e duhur të prindërve për të njohur psikologjinë e nxënësve.

E gjitha kjo na shpie në faktin e diskriminimit psikologjik dhe pedagogjik, i cili nuk është thjesht dhe vetëm braktisje shkollore, por një problem që e shoqëron një fëmijë gjatë gjithë jetës, duke ndikuar në zgjedhjet e vazhdueshme që ai bën në jetë.

Nisur nga ky fakt, zërthimi që Jean Piaget i bën psikologjisë së fëmijës, nisur nga veprimtaria dhe zhvillimi i saj në kuptimin e përvojës dhe të zbulimit, ajo që na intereson ne nga ky autor është përvoja e zbulimit.

Sa aftësi ka një mësimdhënës për të zbuluar!?
Procesi i të zbuluarit nuk kërkon ndonjë angazhim tepër të veçantë dhe as ndonjë tregues shtesë inteligjence, përpos dëshirës tepër njerëzore, për të qenë i ndërgjegjshëm se ti ke përpara teje një botë që duhet zbuluar. Për këtë mjafton vetëm aftësia për të gjetur

Adriatike LAMI - AVA

mekanizmin e duhur, atë që ti e ke të lehtë ta përdorësh dhe që në të njëjtën kohë i shkon mirë mentalitetit të fëmijës për këtë rast.

Zbulimi i një fëmije që rrethohet nga frika dhe frenimi, është një proces sa i gjatë aq edhe i shkurtër, por mbi të gjitha është tepër praktik. Duhet të karakterizohet nga vëzhgimi i përhershëm.

Në përditshmërinë shkollore ndeshim rëndom raste si ky i mëposhtmi:

Njëherë në klasën e gjashtë të një shkolle në Tiranë, një nxënës nuk kishte folur për një kohë të gjatë. Dhe natyrisht ishte vlerësuar me notë negative. As për këtë ishte ndjerë. Në një test me shkrim fëmija reflektoi një rezultat të mirë. Mësuesi “i çuditur” ndalet për ta “eksploruar”. Por natyrisht ky është një rast që përfundon mirë.

Në raste të tjera fëmija nuk flet fare dhe bie në një gjendje gjumë tepër të gjatë. Për të mos folur për rastet kur ai ndjen frikë, ose ndjen që nuk ia vlen të flasë fare.

Në një tjetër rast një nxënës vlerësohet me 7 në edukimin muzikor, ndërkohë që kishte rezultate tepër të larta në lëndët e tjera. Nxënësi nuk reagon ndaj vlerësimit, megjithëse shokohet nga ai dhe në familje tregon me ndrojtje notën e tij, nga frika se do t’i vihej në pah edhe aty paaftësia muzikore.

-E po mirë,- i thotë prindi,- se mos di të këndosh ti...
-Po, pra, po,- i thotë fëmija,- por problemi është se kush më pyeti mua nëse di të këndojo apo jo! ...

Në të dyja rastet ajo që në të cilën vlen të ndalemi nuk është fakti, por qëndrimi ndaj këtij fakti dhe, mbi të gjitha, pasoja e tij, që në të dyja gjasat na shpie te frika dhe indiferenca.

Natyrisht, këto janë shembuj mjaft të thjeshtë të dukjes së treguesve për të cilët po flasim, por ajo që unë dëshiroja të vija në dukje ishte thjesht prezenca dhe mjedisi në të cilin ato shfaqin, duke ua lënë në dorë gjithçka tjetër pjesëmarrësve në këtë proces të gjatë dhe vendimtar jetësor.



Mbi supervizionin e shkollës-si komponent themelor i sistemit të monitorimit të cilësisë arsimore

Vladimir PASKU/IKAP

Hyrje

Një nga rolet kryesore të çdo sistemi supervizues është të monitorojë cilësinë e arsimit, d.m.th. të shkollave dhe të mësuesve. Duke qenë se ky monitorim duhet të ketë efekt pozitiv në cilësinë e tyre, supervizioni përfaqëson vetëm një pjesë të sistemit të përgjithshëm të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë, i cili përmban edhe komponentë të tjerë, si: sistemin e provimeve kombëtare; përcaktimin e kornizës së kurrikulës kombëtare; sistemin e trajnimit (fillestar dhe në shërbim i mësuesve); përvojat vetëvlerësuese të shkollave dhe mësuesve etj. Shteti, nëpërmjet kombinimit të gjithë këtyre mekanizmave në nivelet qendrore, rajonale dhe lokale, mund ta influencojë atë që ndodh në shkolla dhe të sigurojë ruajtjen e standardeve të cilësisë brenda sistemit arsimor.

Për një kohë të gjatë, supervizioni ka qenë një fushë e neglizhuar e menaxhimit arsimor. Gjatë viteve 1970, në disa vende, fjala “inspektor”, madje edhe ajo “supervizor”, kishte një konotacion negativ të fortë. Inspektimi shihej si një institucion jo demokratik i modës së vjetër, aq sa disa vende hoqën dorë jo vetëm nga terminologjia, por edhe nga vetë shërbimi i supervizionit. Edhe sot, është simptomatik fakti që shumë vende nuk publikojnë asnjë të dhënë ose statistika që burojnë nga supervizioni, ose shërbimet e tij mbështetëse. Sidoqoftë, duke filluar nga vitet 1990, rishfaqet fuqishëm interesi mbarëbotëror për problemet e cilësisë, pra për monitorimin dhe supervizionin e saj. Disa vende, që e kishin çmontuar supervizionin, e ringritën përsëri (Filipinet); vende të tjera (Kina dhe Suedia), që nuk e kishin, e kanë ngritur atë. Por, ajo që ka rëndësi është fakti që çdo vit rritet numri i vendeve që kanë filluar procesin e riorganizimit dhe forcimit të supervizionit. Pjesë e këtyre zhvillimeve është edhe institucionalizimi i IKAP-it, si një institucion vlerësues jashtë strukturave të MASH dhe DAR-eve.

Arsyet për interesin e ri për supervizionin

Katër prej arsyeve themelore që qëndrojnë prapa këtij interesi në rritje ndaj supervizionit dhe monitorimit të cilësisë janë:

1. Në shumë vende ka një perceptim, sipas të cilit zhvillimi i shpejtë i arsimit ka sjell ulje të cilësisë. Rrjedhimisht, përmirësimi i cilësisë është shndërruar në prioritetin kryesor të politikanëve, gjë që ka rritur preokupimin e tyre për kontrollin e cilësisë.
2. Pak kohë më parë, sindroma “vlëra sipas parasë”, e përdorur në të gjithë sektorët e shoqërisë, ka prekur edhe sistemin arsimor. Ajo është e lidhur me rritjen e kërkesës për përgjegjshmëri më të lartë në shërbimet publike. Në këtë mënyrë, kërkesa tradicionale për cilësi dhe efektivitet është shndërruar në kërkesë për eficiencë, pra në kërkesë për mekanizma të fortë kontrolli.
3. Duke qenë se një nga arsyet themelore të rënies së cilësisë së shkollave është direkt e lidhur me cilësinë e dobët të instrumenteve monitorues, rritja e interesit për procedura eficiente të supervizionit është shoqëruar me rivendosjen e inspektimit në disa nga vendet që e kishin

hequr inspektimin gjatë viteve 1970.

4. Së fundi, në shumë vende të botës, shkollat janë duke marrë më shumë liri për vendimarrje në çështje të tilla themelore, si: kurrikula, menaxhimi i stafit dhe buxheti. Kjo shkallë lirie në rritje e shkollave është shoqëruar me rritje të kërkesës për përgjegjshmëri në nivel shkollë dhe për procedura monitoruese, të cilat do t'i lejojnë qeveritë qendrore të garantojnë standardet e cilësisë dhe të barazisë në tërë sistemin arsimor. Detyrë kjo të cilën e kryen inspektimi.

Një përcaktim operacional i supervizionit dhe monitorimit

Sidoqoftë, gjatë historisë së tyre të gjatë shërbimet e supervizionit janë shndërruar në sisteme komplekse dhe të përpunuar, me terminologji dhe role të ndryshme. Prandaj, është me interes të sqarojmë një përcaktim operacional të supervizionit, me synim një analizë të fokusuar brenda kufijve të qartë.

Termi ‘shërbimet e supervizionit’ nënkupton ato shërbime, funksioni kryesor i të cilëve është: (1) **të inspektojnë, kontrollojnë, vlerësojnë**; dhe/ose (2) **të këshillojnë, asistojnë e të mbështetin drejtorët e shkollave dhe mësuesit**. Për rrjedhojë, karakteristikat kryesore të punës së gjithë zyrtarëve të këtij shërbimi janë:

- Roli i tyre eksplisit kontrollues dhe/ose mbështetës;
- Vendosja e tyre vendosur jashtë shkollës; dhe
- Vizitat e rregullta në shkolla, si një pjesë esenciale e mandatit të tyre.

Por, ç’kuptojmë me monitorim dhe cilët janë komponentët e tij të ndryshëm; cila është mënyra e lidhjes së sistemeve të ndryshme monitoruese me praktikën e supervizionit?

Monitorimi mund të përcaktohet si **proces menaxhues i brendshëm i kontrollit të vazhdueshëm të inputeve, proceseve dhe rezultateve, me synim identifikimin e pikave të forta dhe atyre të dobëta, formulimin e propozimeve praktike për veprimin që duhet ndër-marr dhe marrjen e masave të domosdoshme për arritjen e rezultateve të pritshme**. Siç shihet, aspektet e rëndësishme të këtij përcaktimi janë:

1. Monitorimi është pjesë e menaxhimit, jo diçka e shtuar nga jashtë;





2. Ai është një proces i vazhdueshëm, jo një veprim i veçuar;

3. Ai ka të bëjë me identifikimin e pikave të forta dhe atyre të dobëta, si dhe formulimin e propozimeve për veprim;

4. Monitorimi është i orientuar drejt rezultateve - ai synon një përcaktim të qartë dhe të matshëm të rezultateve të pritshme;

5. Monitorimi nuk mbaron me formulimin e propozimeve - ai përfshin edhe ndërmarrjen e veprimit për zgjidhjen e problemeve dhe arritjen e objektivave.

Nga këndvështrimi pragmatik i IKAP-it, monitorimi (pra edhe supervizioni) përfshin tre aktivitete themelore: **grumbullimi i informacionit, analiza e tij dhe veprimi që ndërmerret**. Këto aktivitete udhëhiqen nga një grup standardesh të asaj që quhet 'cilësi'. Konkretisht, monitorimi i cilësisë së arsimit mund të kryhet vetëm mbi bazën e një informacioni të qëndrueshëm. Ky informacion mund të vijë nga burime të ndryshme, nga të cilët më të përhapurit janë: të dhënat e rregullta shkollore; rezultatet e provimeve dhe të testeve; raportet e inspektorëve, si dhe raportet studimore/vlerësuese. Sigurisht, IKAP,ën të besueshëm monitorimin nëpërmjet dobishmërisë së të dhënave për analizën e problemeve. Më pas, këto të dhëna analizohen për të përcaktuar arritjet,

problemet, si dhe për të propozuar veprimet që duhet të ndërmerren. Kjo kërkon zgjedhjen dhe ndërtimin e treguesve të besueshëm, analiza e të cilëve kryhet duke përdorur pika të qarta të referencës ose të standardeve për formulimin e vlerësimeve. Rrjedhimisht, midis treguesve dhe standardeve ka një lidhje të brendshme. Ndërsa **treguesit** janë rezultat i vëzhgimit empirik dhe shërbejnë si matësa të asaj që ndodh në realitet, **standartet** përdoren si pika referimi, pika krahasimi për të bërë vlerësime rreth treguesve. Në këtë proces, pikat e referimit që përdor IKAP përbëhen nga **norma të paracaktuara**, si p.sh. ato për madhësinë e klasës, normën mësimore dhe/ose kualifikimet e mësuesit; **niveli mesatar i arritjeve**, të tilla, si p.sh. renditja në provimet e lirimt/Maturën Shtetërore në matematikë; **objektivat e politikës arsimore** ose rezultatet e pritshme, të tilla si kalueshmëri 5% më e lartë në klasën e 10 etj. **Veprimi** veprimi përfaqëson një komponent themelor të monitorimit. Ai mund të jetë parandalues, korrigjues ose përmirësues. Nga këndvështrimi studimor, mbledhja e të dhënave dhe analiza e tyre nuk kanë kuptim nëse nuk shoqërohen me veprimin; kurse nga këndvështrimi menaxhues një proces i tillë është steril. Është kjo arsyeja përse pjesë e veprimeve të ndërmarra me shtysën e IKAP-it kanë formën e: **masave strukturore** (nëse struktura ekzistuese ka rezultuar problematike) **dhe masave të lidhura me personelin** (të cilat kanë qenë nxitëse ose disiplinore).

Konkluzion

Krijimi i IKAP-it është në koherencë të plotë me tendencën globale të fuqizimit të sistemit të supervizionit shkollor. Si një institucion në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, ai është identifikuar si shërbim me rol të qartë inspektues, i vendosur jashtë shkollës, por që viziton rregullisht shkollat për vlerësimin e cilësisë së punës së tyre. I gjithë ky proces kryhet nëpërmjet grumbullimit të të dhënave për aspekte të ndryshme të cilësisë së shkollës, identifikimit të pikave të saj të forta dhe të problemeve që duhen përmirësuar dhe masave që duhen ndërmarrë për realizimin e këtij përmirësimi.



Vlerësimi vjetor i punës së mësuesit

Vlerësimi i punës së mësuesit përbën një proces shumë të rëndësishëm dhe delikat që lidhet me një sërë aspektesh të punës së tij si: karriera dhe ndryshimet e mundshme, formimi i tij profesional dhe shkencor dhe statusi i tij profesional dhe social.

Miranda KURTI /Specialiste në IKAP

Në çdo fillim viti shkollor, për shkak të ristrukturimit të shkollave, ndryshimit të numrit të nxënësve, ndryshimit të mundshëm të kurrikulave shkollore, por më kryesore për shkak të përmirësimit të administrimit shkollor apo të mësimdhënies, DAR/ ZA bëjnë ndryshime në kuadrin drejtues dhe mësimdhënës në shkolla. Për këtë shkak një nga instrumentet kryesore që përdoret, sidomos për uljet apo ngritjet në karrierë, është vlerësimi i punës së mësuesit.

Vlerësimi i punës së mësuesit përbën një proces shumë të rëndësishëm dhe delikat që lidhet me një sërë aspektesh të punës së tij si: karriera dhe ndryshimet e mundshme, formimi i tij profesional dhe shkencor dhe statusi i tij profesional dhe social. Rrugët e realizimit në praktikë të vlerësimit janë të ndryshme.

- **Vlerësimi i brendshëm.**

- **Vlerësim i jashtëm.**

Vlerësimi i brendshëm konsiderohet vlerësimi i cili kryhet nga drejtori i shkollës në fund të çdo viti mësimor. Një kopje e këtij vlerësimi si rregull depozitohet në Sektorin e Burimeve Njerëzore nga ku vendoset në dosjen personale të mësuesit. Përgjithësisht, po t'ju hedhësh një sy këtyre vlerësimeve, me ndonjë përjashtim, vihen re formate shabllone dhe të plotësuara në mënyrë uniforme nga drejtori i shkollës.

Në të vërtetë, të gjitha vlerësimet janë standarde dhe të unifikuara në mënyrë të atillë, saqë nuk je në gjendje të bësh dallime mes mësuesve me tregues të lartë dhe atyre me tregues aspak të kënaqshëm.

Po pse ndodh kështu? Pikërisht këtu qëndron kauza e vlerësimit të punës, pasi drejtori i shkollës nuk vlerëson punën e mësuesit, por vlerëson mësuesin duke mos dashur që të hyjë në konflikt me të. Drejtori mund të ketë dhjetëra vërejtje për punën e disa mësuesve, por nuk i pasqyron ato në vlerësimin e tij të punës. Ky mentalitet i gabuar i drejtuesve të shkollave rëndon drejtpërdrejt mbi cilësinë e mësimdhënies. Vlerësimi korrekt nga drejtorët e shkollës, për secilin mësues, është një motiv i qartë për të arritur sukses dhe cilësi në procesin e mësimdhënies. Duke patur një vlerësim korrekt për punën e gjithsecilit, në dosjen e tij, DAR-ZA e kanë më të lehtë emërimin dhe përzgjedhjen e kuadrit, në përshtatje me udhëzimet e dala nga MASH. Çdo mësues dhe drejtor duhet ta ketë të qartë se në fund të çdo viti do të vlerësohet për punën dhe se ky vlerësim do të shërbejë si motivim për konkurrencën dhe mbrojtjen e vendit të punës. Shpesh, dëgjon të flitet për mësues që prej vitësh janë të papërgjegjshëm, që gjithë brezat që nxjerrin kanë mangësi në lëndën e tyre, që vijnë të papërgatitur në mësim, që nuk korrigjojnë testet me shkrim të nxënësve, madje që përdorin dhunë fizike

dhe psikologjike mbi nxënësit dhe që këto të meta e dobësi nuk pasqyrohen në vlerësimin vjetor të punës së tyre. Gjatë të gjithë vitit, çdo drejtor e ka për detyrë që të mbajë vërejtjet dhe problemet në punë për secilin mësues dhe, jo vetëm që duhet t'i bëjë ato objekt të analizave në stafin pedagogjik, por dhe t'i dokumentojë ato dhe t'i shfrytëzojë në vlerësimin vjetor të punës për secilin mësues. Një drejtor vizionar dhe një menaxher e drejtues i suksesshëm duhet ta ketë objektivat e planit të punës edhe vlerësimin e mësuesve si pjesë e veprimtarisë vjetore dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor. Drejtori i shkollës nëpërmjet një vlerësimi korrekt, paraqet jo vetëm dobësitë, por edhe aftësitë e stafit që ai drejton



dhe me këtë ai ndikon edhe në informimin e komunitetit për punën dhe aftësitë e gjithsecilit.

Vlerësimi i punës duhet të realizohet, jo vetëm si vlerësim i brendshëm i drejtorit, por dhe si vlerësim i jashtëm i cili lidhet me komponentë të tjerë të rëndësishëm në procesin mësimor si: bordi i shkollës, këshillat e prindërve, qeveria e nxënësve etj. Bashkëpunimi dhe partneriteti i përbashkët krijon bashkëpërgjegjësi për rritje të cilësisë në procesin mësimor. Vlerësimi i punës së mësuesit nga prindërit dhe nxënësit nëpërmjet anketave dhe pyetësorëve do të ndikojë drejtpërdrejt në mbarëvajtjen e procesit mësimor. Nxënësit janë ata që në të shumtën e rasteve diskutojnë dhe madje janë në gjendje që të vlerësojnë njohuritë që marrin nga mësuesit e tyre si dhe aftësitë e tyre didaktike, pedagogjike e profesionale. Prindërit luajnë një rol të rëndësishëm në vlerësimin e punës së mësuesit pasi ata komunikojnë më drejtpërdrejt me fëmijët e tyre, njohin më nga afër shqetësimet e tyre si dhe kuptojnë qartë seriozitetin dhe korrektësinë në punë të gjithsecilit mësues për cilësinë e procesit mësimor të ofruar prej tij. Tërheqja dhe mbajtja në punë e mësuesve cilësor kërkon që MASH dhe IZHA, në bashkëpunim dhe me grupe mbështetëse, të hartojnë skema të reja motivimi dhe vlerësimi me një format të plotë ku të detajohen të gjitha aspektet e punës së mësuesit që nga disiplina në punë e deri tek arritjet dhe rezultatet e nxënësve. Mësuesi mbetet udhërrëfyes i dijes, pasqyra e shkollës dhe njeriu me i vlerësuar i shoqërisë. Vetëm mësuesi mund ta ndryshojë shkollën, të edukojë nxënësin dhe të ndryshojë shoqërinë.

Niveli i shkollimit të të rinjve dhe nevojat e zhvillimit ekonomike shoqëror të vendit

Prof. dr. Pajtim BEJTJA

Prirja për t'i bërë me universitet të gjithë ata që marrin maturën, është bërë e shkajshme në shoqërinë shqiptare. Kjo prirje mbështetet, më së pari, nga prindërit, të cilët, pavarësisht nga aftësitë, prirjet dhe rezultatet reale të fëmijëve të tyre në shkollën e mesme, ngulmojnë që këta me çdo mënyrë të marrin një diplomë universitare dhe madje të konkurrojnë në degë që sigurojnë status të lartë ose të ardhura të mëdha në punë.

Arsimi -çështje jetike për shoqërinë dhe individët

Siç dihet, shoqëria njerëzore, për të siguruar ekzistencën dhe zhvillimin e saj të pandërprerë, ka nevojë që pjesëtarët e saj të kryejnë veprimtari të shumta e të larmishme. Kryerja me sukses e këtyre veprimtarive kërkon, zakonisht, që njerëzit të marrin paraprakisht kualifikime profesionale të llojeve e të niveleve të ndryshme, që sigurohen kryesisht nëpërmjet arsimimit të tyre. Vetëm pak lloje veprimtarish mund të kryhen pa marrë kualifikim, kryesisht nëpërmjet të ushtruarit praktik në vendin e punës. Tradicionalisht, shumica e vendeve të punës ka kërkuar arsim të mesëm profesional (të nivelit të punëtorit e të teknikut) e, në një farë mase, arsim të lartë jouniversitar (postsekondar) dhe relativisht pak vende pune kanë kërkuar arsim të lartë universitar (në kuptimin e përgjithshëm edhe arsimi i lartë konsiderohet arsim profesional). Megjithatë, me zhvillimet e sotme shkencore e teknologjike, në sajë të futjes gjithnjë e më të gjerë të teknologjisë së informimit e të komunikimit në të gjitha sferat e jetës dhe të veprimtarisë njerëzore dhe nën ndikimin e faktorëve të tjerë ekonomiko-shoqërorë, është rritur përqindja e kërkesave për kualifikime të nivelit universitar. Kjo ndodh veçanërisht në vendet e zhvilluara, në të cilat prodhimi zë një vend të konsiderueshëm në krahasim me vendet e tjera dhe, përveç kësaj, ekzistojnë edhe fusha veprimtarie të nivelit të lartë shkencor e teknologjik, që nuk kanë të ngjarë në vendet e tjera. Kështu, sipas një studimi të Këshillit të Evropës (2004), në 2010-n gati 50 për qind e vendeve të reja të punës do të kërkonin nivel universitar kualifikimesh, më pak se 40 për qind do të kërkonin shkollim të mesëm dhe vetëm rreth 15 për qind e tyre do të kërkonin shkollim bazë.

Niveli i shkollimit të të rinjve është një problem i rëndësishëm, që u intereson si individëve, ashtu edhe shoqërisë në tërësi, prandaj duhet parë në të dyja këto plane dhe duke marrë parasysh të gjithë faktorët ndikues.

Në një shoqëri demokratike, çdo individ duhet të marrë vetë përgjegjësi për llojin dhe nivelin e arsimimit të tij, kurse shoqëria duhet t'i sigurojë atij mundësi optimale për të realizuar dëshirat dhe kërkesat e veta. Njëkohësisht, ajo duhet ta orientojë dhe ta këshillojë atë për të bërë zgjedhjet e duhura, duke u bazuar jo vetëm në dëshira, por edhe në aftësitë (të dorës, intelektuale etj.) dhe në veçoritë psikologjike të tij, në mundësitë e punësimit, si dhe në faktorë të tjerë ndikues (ekonomikë etj.). Kjo realizohet nëpërmjet shërbimit të orientimit dhe të këshillimit shkollor e profesional (për karrierë), i cili në shumë vende të botës është mjaft i zhvilluar. Me rëndësi është që zgjedhjet të bëhen edhe duke harmonizuar interesat, aftësitë dhe

dëshirat individuale me interesat, nevojat dhe mundësitë e shoqërisë, për disa arsye. Së pari, arsimi nuk është qëllim në vetvete, po një mjet i rëndësishëm, që i armatos njerëzit për të kryer në mënyrë cilësore detyrat që lidhen me ekzistencën dhe përparimin e shoqërisë. Së dyti, çdo shoqëri, sado e zhvilluar të jetë, nuk mund t'i plotësojë në maksimum dëshirat e të gjithë të rinjve. Së treti, dëshira për të marrë arsim të lartë, që vërehet te shumë të rinj, në shumë raste, nuk u përgjigjet aftësive të duhura për të përballuar me sukses këtë nivel arsimi. Natyrisht, çdo i ri ose e re ka të drejtë të synojë për arsim të lartë të çdo fushe dhe mund të mos i marrë parasysh këshillat dhe të provojë t'i masë forcat e veta, por dështimi do të thotë humbje mudi, kohe e parash, madje dhe zhgënjim me pasoja shëndetësore. Së katërti, një politikë arsimore e bazuar vetëm në kërkesat e të rinjve dhe të prindërve të tyre për arsim të lartë, pa marrë parasysh nevojat e shoqërisë, përkatësisht kërkesat e tregut të punës, çon në superprodhim specialistësh të lartë për fusha të ndryshme veprimtarie në vend. Për pasojë, ajo çon në pamundësi punësimi sipas diplomës të një numri të konsiderueshëm specialistësh dhe në punësimin e tyre në vende pune që kërkojnë, përgjithësisht, kualifikim të një niveli më të ulët se ai i fituari dhe, në jo pak raste, të një fushe tjetër. Gjithashtu, ajo çon në mungesë specialistësh të niveleve më të ulëta në tregun e punës, duke bërë që shumë punë të kryhen pa cilësinë e duhur, nga persona që i marrin përsipër ato pa pasur kualifikimin përkatës.

Duke u nisur nga nevojat e shoqërisë, shteti duhet t'i kushtojë kujdes arsimimit dhe formimit profesional të të gjitha niveleve, duke vendosur një raport të drejtë ndërmjet tyre dhe jo të rëndë pas një niveli shkollimi (ose formimi), cilido qoftë ai.

Duhet thënë se, niveli arsimor i lartë i popullsisë në kohën e sotme nuk sigurohet vetëm nëpërmjet arsimimit paraprak të të rinjve. Ai sigurohet, rritet e përditësohet, edhe nëpërmjet të nxëniet gjatë gjithë jetës, i cili tashmë është bërë i domosdoshëm. Të nxënëet gjatë gjithë jetës realizohet me rrugë formale, joformale e informale, me mjete gjithnjë e më të larmishme (tradicionale dhe të reja, elektronike) e në mjedise të ndryshme (arsimore e të formimit, të punës, publike dhe shtëpiake), sipas nevojave e mundësive. BE-ja e ka shpallur vitin 2010 si vit cak për krijimin e hapësirës





evropiane të të nxënit gjatë gjithë jetës. Krijimi i plotë i kësaj hapësire nënkupton që çdo individ mund të nxërë në çdo kohë, në mënyrë periodike a të vijueshme, me ritmet, në drejtimet dhe në nivelet e vendosura prej tij, në varësi nga nevojat dhe kërkesat që ai ka e që mund të ndryshojnë gjatë jetës. Ai bën të mundur që interesat dhe nevojat e individëve të harmonizohen me nevojat dhe kërkesat e shoqërisë. Ai, gjithashtu, bën të mundur që individët t'u përgjigjen në mënyrë të shpejtë ndryshimeve gjithnjë e më të vrullshme që ndodhin në shoqërinë e sotme, në lidhje me mënyrën e të jetuarit e të punuarit.

Si po veprohet në Shqipëri për arsimimin e të rinjve
Në Shqipëri, ndryshimi në fillim të viteve '90 i rendit ekonomiko-shoqëror, kalimi nga një ekonomi e centralizuar me karakter kryesisht prodhues në një ekonomi private me karakter kryesisht shërbimesh, shtimi i theksuar i papunësisë dhe ndryshimi i natyrës e i kërkesave të tregut të punës, ndikuan thellësisht në sistemin arsimor, veçanërisht në arsimin parauniversitar. Një ndër ndryshimet e rëndësishme që ndodhën, ishte mbyllja e shumë shkollave të mesme profesionale, sidomos e atyre bujqësore në fshat dhe, për pasojë, rënia në mënyrë drastike e numrit të nxënësve në arsimin profesional, duke u përmbysur, kësaj, raporti i numrit të nxënësve në shkollat e mesme profesionale me atë të nxënësve në shkollat e mesme të përgjithshme. Sipas të dhënave të MASH-it, brenda një periudhe gjashtëmbëdhjetëvjeçare (1990-2006), numri i nxënësve në shkollat e mesme të përgjithshme është mbidfishuar, duke arritur në një raport 80:20 % me nxënësit e shkollave të mesme profesionale. Nxënësit e shkollave të mesme të përgjithshme, duke mos marrë ndonjë profesion nga shkolla, synojnë në masë drejt arsimin të lartë, duke e vlerësuar diplomën universitare si një mjet që u krijon një status më të lartë dhe mundësi më të mëdha punësimi, veçanërisht në administratë ku, për t'u punësuar, nga punëdhënësit kërkohet, përgjithësisht, diplomë e nivelin universitar, pavarësisht nga lloji i kualifikimit.

Prirja për t'i bërë me universitet të gjithë ata që marrin maturën, është bërë e skajshme në shoqërinë shqiptare. Kjo prirje mbështetet, më së pari, nga prindërit, të cilët, pavarësisht nga aftësitë, prirjet dhe rezultatet reale të fëmijëve të tyre në shkollën e mesme, ngulmojnë që këta me çdo mënyrë të marrin një diplomë universitare dhe madje të konkurrojnë në degë që sigurojnë status të lartë ose të ardhura të mëdha në punë.

Shteti po u përgjigjet në mënyrë të sforcuar dëshirave të

të rinjve dhe të prindërve të tyre, duke hapur degë të reja e rritur në një masë të konsiderueshme numrin e pranimeve në universitetet ekzistuese. Sipas INSTAT-it (botimi: Shqipëria në shifra, 2008), gjatë katër viteve shkollore të mara në shqyrtim (2003-2006), numri i studentëve për 1000 banorë është rritur nga 17 në 27; synohet që të çohet në 40. Nga ana tjetër, është krijuar dhe po zgjerohet vazhdimisht rrjeti paralel i universiteteve jopublike (private), numri i të cilave është gati sa trefishi i numrit të universiteteve shtetërore. Sipas Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë- APAAL, sot në Shqipëri ekzistojnë 46 institucione të arsimit të lartë (12 publike dhe 34 private; nga këto të fundit 9 janë akredituar plotësisht dhe 3 me kusht për programe të veçanta) dhe ka prirje e bëhen presione për hapjen e universiteteve edhe në disa qytete të tjera. Përveç kësaj, me mijëra të rinj nisen çdo vit për studime të larta jashtë shtetit, privatisht ose me bursa, kryesisht në Itali e SHBA, po edhe në vende të tjera, një pjesë e mirë e të cilëve, me mbarimin e studimeve, kthehen me dëshirën për të punuar në vend.

Si argument kryesor, "çarmatosës", në mbështetje të nevojës për zgjerimin me ritme kaq të shpejta që po i bëhet arsimin universitar në Shqipëri, përveç balancimit të raportit kërkesë-ofertë, sillet fakti që prirja për rritjen e përqindjes së popullsisë me arsim universitar nuk është një dukuri vetëm shqiptare, po vërehet në shumë vende, duke përfshirë, madje, edhe vendet e vogla fqinje. Gjithashtu, në shtyp janë dhënë shifra, sipas të cilave në Bashkimin Evropian dhe në SHBA popullsia që zotëron arsim universitar lëviz në kufijtë 36-42 për qind, kurse në Shqipëri është 7-8 për qind, madje në zonat rurale zbret në 2 për qind (duhet pasur parasysh që shifrat për vendin tonë janë në rritje). Nga ana tjetër, vihet në dukje fakti se edhe në vende të tjera ka plot të rinj me diplomë universitare, që punojnë, p.sh., si kamerier apo bëjnë punë të tjera, jashtë fushës për të cilën janë diplomuar e që mund të përvetësohen nëpërmjet të ushtruarit (praktikës), me kurse formimi profesional apo, shumë-shumë, duke ndjekur ndonjë shkollë profesionale 2-3-vjeçare.

Në mbështetje të zgjerimit të shpejtë të arsimit universitar është edhe pikëpamja sipas së cilës një nivel i lartë arsimimi i popullsisë, edhe pse i tejkalon nevojat e vendit për nivele dhe lloje të ndryshme kualifikimi, është i dobishëm, prandaj shpenzimet që bëhen për arritjen e tij nuk duhen quajtur të kota.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

Një ditë tek shkolla “Teknike-Ekonomike” e Tiranës

Oborri i shkollës së mesme Ekonomike në Tiranë mëngjesin e kësaj vjeshte të tretë ishte më se i qetë dhe i pastër. Gjithashtu edhe korridoret e shkollës, ku herë pas here ecejaket kujdestari i shkollës, e ndërsa dera e drejtoreshës Merita Zylaj, ishte e hapur dhe dukej se priste njerëz.

I shprehim qëllimin e vizitës sonë në shkollën e tyre dhe Merita duket se e pret me qetësi dhe mirëkuptim. -Kemi ç'të themi dhe të shënojmë për risitë e ndodhura në shkollën tonë. Ajo ç'ka dua të them, është fryma reformuese dhe përshtatshmëria që nga kurrikula e re e deri tek binjakëzimet e elementeve të rëndësishëm të shkollës, me simotrat tona në Evropë.

Tek e dëgjomë Meritën, që mend nuk merr frymë, kur të rendit një sërë veprimtarish dhe aksionesh sa me karakter praktik aq edhe me karakter politikbërjeje, të vete mendja tek përpjekjet e mëdha që ka bërë dhe po bën shkolla jonë profesionale për të qenë pjesë integrale e arsimit profesional në Evropë.

Ajo çka duhet të ndodhe, është përmbysja e mendësive dhe mentaliteteve frenuese për vendin dhe rolin e këtij lloj arsimit në një shoqërinë multidimensionale dhe demokratike si kjo e jona.

Nxënësit tanë të këtueshëm, apo më saktë kontingjentet e tyre brenda shkollës, jetojnë me idenë e përmirësimit të të gjithë infrastrukturës së shkollës, për ta kthyer atë në një shkollë praktike dhe njëkohësisht të adaptueshme për një nivel më të lartë teknik dhe teorik për tu integruar natyrshëm, në shkollat e larta të profilizuara ose të përgjithshme.

Fakti që na bën më flerksibël, është se kemi një këshillim të shkëlqyer karriere për ata që duan të trokasin në dyer e shkollës sonë.

Dhe kësaj ideje duket se i mëshon edhe mësuesja Adriana Çoçoli.

-Ja hidhini një vështrim klasës së dytë të shkollës dhe ve re se kurrikula ka ndryshuar. Është më e drejtpërdrejtë në synimin e lëndës dhe dijeve që duhet të përftojnë nxënësit. Është aq teorike sa të mundëson të ndjekësh hapa të mëtejshme shkollimi pas saj, si dhe njëkohësisht, është aq praktike sa të integron menjëherë në tregun e punës si një ekonomist dhe kryerje detyrash të tilla kudo që të të jepet mundësia. Në këtë kurrikul pesha specifike e lëndës është e baraspeshuar më atë të praktikave profesionale. Kësisoj dy vitet e parë të shkollimit janë të përgjithshme dhe vetën në dy vitet e tjera nxënësi ka mundësi të profilizohet në Bankë, Tatime, Sigurime etj.

Ka një merak që sic duket drejtoresha dhe mësuesja janë në një dilemë të pozimit të saj ose jo përpara

nesh, por më se fundi ato flasin:

Ajo që na shqetëson, është fakti se nuk mundemi dot që praktikat profesionale ti zhvillojmë sikurse dëshirojmë në dhe nxënësit pranë kompanive të mëdha të biznesit dhe atyre të industrisë. Është mëse e qartë se duke pasur mundësi të venë në jetë dijet e fituara në shkollë tek këto kompani, nxënësit janë të aftë të përfitojnë sa më shumë njohuri të tjera nga to, porse kane mundësinë të provojnë dhe veten me dijet e mara në shkollë. Shkurt, kjo që do t'ia riste shumë më shumë prestigjin shkollës profesionale dhe njëkohë-

sisht edhe përgjegjësinë që ajo ka ndaj nxënësve, komunitetit dhe shoqërisë. Duket se mësuesja, teksa vendos vetën e përgjithësimin në bashkëbisedimin tonë, ka kaluar ndërkohë edhe në vitet e shkuara tek historiku i shkollës

Shkolla sot quhet Teknike-Ekonomike. Ajo është shkollë me sistem 5-vjeçar. Lidhjet me GTZ gjermane kanë ndihmuar në trajni-

min e mësuesve specialistë (ekonomistë) dhe për hir të së vërtetës, shkolla zhvillohet e drejtohet me një tjetër filozofi, të tregut dhe filozofinë e hapjes. Nga bashkëpunimi 2 palësh është bërë i mundur realizimi i disa teksteve mesimore të lëndëve profesionale që ndihmojnë drejtpërdrejt në marrjen e njohurive mbi konceptet e ekonomisë së tregut. U mundësua përveç degës Turizëm edhe ristrukturimi i degëve të specialitetit si: banka, tatime, sigurime.

Hapja e zyrave mesimore aftëson nxënësit për atë që do të bëjnë nesër në jetë.

Marrja edhe e njohurive mbi kompjuterin e bën nxënësin të mbarojë shkollën si teknik i mesëm i kompletuar.

Në shkollë krahas anglishtes studiohet edhe gjuha gjermane. Mësojmë se në 2001 me ndihmen e fondacionit gjerman “CIM” + projekti “PARSH” u ngrit kabineti i gjermanishtes me përfaqësues Johan Blanken i pajisur me bazë materiale moderne, tekste në gjuhën gjermane si edhe pajisje elektronike (TV, Video, projektor). Në ambientet e shkollës në bashkëpunim me Institutin e gjuhës gjermane “Gëte” duke e bërë sa më atraktive, zhvillohen kurse të gjuhës gjermane. Nxënësit janë pajisur me çertifikata që njihen në të gjithë Europën. Në vitin 2002 stafin pedagogjik të shkollës e kanë mbështetur edhe përfaqësues austriak si Heide Fischer, Manfred Tagini (deri në vitin 2008) të cilët dhanë kontribut në mësimin e gjuhës gjermane.

Krahas zyrave mesimore të praktikës profesionale, në shkollë është hapur edhe kabineti i Agjensisë Turistike,





ku drejtojnë Hamide Konica, Adriana Kalaja, Adriana Çoçoli, Mimoza Veizi.

Nga janari i vitit 2000 funksionojnë tre firma ushtrimore "Vizion 2000", "Deglis 130", "Vjollca & Moza". (me mësuese Ira Roço, Lindita Haxhijaj, Teuta Veleshnja, Nevila Skënderi, Silvana Kotja, Valbona Xibraku. Më vonë ky rrjet u zgjerua edhe me dy firma të tjera "Shanoma Bank 2001" dhe "Travel and Fun 2002". Në shkollën Teknike-Ekonomike që nga fillimet e saj në vitin 2002 zhvillohet Panairi Kombëtar i Firmave Ushtrimore në bashkëpunim me MASH dhe Kultur Kontakt Austria, ku firmat ushtrimore të shkollës tonë kanë qenë fituese disa herë të vendeve të para, të dyta dhe të treta, duke vlerësuar punën e mësuesve dhe përgatitjen e nxënësve

Në vitin shkollor 2009-2010 mbarojnë shkollën 184 maturantë

Shkolla Teknike Ekonomike është dalluar për përgatitjen profesionale dhe të përgjithshme të nxënësve duke u vlerësuar:

Në vitin 2005 nga Bashkia Tiranë "Shkolla e mesme me mesatare më të lartë".

Në vitin 2007 nga MASH "Dalluar në Maturën 2007"

Në vitin 2008 nga Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë "Vendi i tretë si shkollë e suksesshme"

Kjo shkollë ka marre pjesë në shumë projekte ndër vite. Projekti GTZ gjermane, PARSH, ECO NET (për firmat ushtrimore), CIM, Kultur Kontakt Austria për panairët e firmave ushtrimore. Dy nga projektet më të fundit ku nxënësit e shkollës janë aktivë dhe kanë treguar formim të lartë shkencor dhe profesional janë :

"Anglishtja për tregun e Punës (English for World of Work), (2008) dhe 'Aftësitë në Punë' (Skills of Work)(2009)..Të dyja këto projekte financohen nga Këshilli Britanik. Në vazhdim është edhe bashkëpunimi me Bradford College (2009 -2010) në Angli për përmirësimin e materialeve mëimore të degës Turizëm dhe trajnimin e mësuesve. Shkolla ka qenë pjesë e programit të USAID (e Qeverisë Amerikane)" Junior Achievement Albania". Në panairin Kombëtar të Kompanive të nxënësve (Kompani = firma që operojnë realisht me Cash) është fituese

e vendit të parë dhe të tretë me kompanitë "Golden Hands" dhe "Puppies & Girls" në vitin 2008.

Në vitin 2009 shkolla është pjesë e projektit "AL BIZ" (Albanian Business Schools) - Pjesë e Reformës së arsimit të mesëm ekonomik në Shqipëri 2009- 2013"- Bashkëpunim i Kultur Kontakt me MASH ku po punohet nëpërmjet trajnimit jo vetëm të drejtuesve të shkollës, por edhe të mësuesve të lëndëve profesionale dhe atyre të TIK në "sigurimin dhe rritjen e cilësisë dhe përafrimin me tregun e punës"

Në në klasën 5 c Anita Bani, mësuesja e financës publike, ka vënë në punë në orën E lëndës së saj të gjithë nxënësit. Është ndezur pauer poiti që reflekton në murin pas derës, dhe shfaqen pamjet e një sekuence

filmime ku njerës te ndryshem parakalojne ne monitor, vende te prapambetura, pallate gjigande.

Të duket se je në një kohë jashtë kohe tëksa mendon se ke të bësh me shkollë ekonomike...

Pikërisht sot ne kemi në temë studimi rolin e shtetit në ekonomi, të thonë nxënësit dhe kemi sjellë të tilla materiale filmime që e mundësojnë kuptimin sa më të gjërë dhe të thellë të rolit të shtetit në ekonomi, rolin zhvillues dhe frenues të tij, llojet e shteteve etj, rolin e policit, gjendjen e mbeturinave, riciklimin,... gjithcka që ka të bëjë me financat publike, menaxhimin, transformimin dhe përdorjen e tyre në dobi të shoqërisë.

Por... nëpër korridorin e gjatë të shkollës teksa drejtohem në një tjetër klasë, drejtoresha Merita pohon jo pa merrak të shpallur:

Kemi mungesa tekstesh dhe na kushton shumë kohë dhe mund, por edhe vlera monetare për nxënësit që të krijojmë, të fotokopjojmë dhe të servirim tekste të cilat do ishte e udhës të përgatiteshin ashtu sic përgatiten tekstet e gjimnazeve, përmes alterteksti. Ne e kuptojmë që vështirësitë qëndrojnë në faktin se për shkollat profesionale numri i kërkesës ofertës, për lëndën Financë publike, është shumë i vogël madje simbolik në raport me nxënësit e gjimnazeve që kërojnë bie fjala kiminë a fizikën e vitit të dytë, dhe askush nuk e merr përsipër, prej botuesve privatë, por...

Le të hyjmë në rrugën e zgjidhjes... ndoshta sic ndodh



me tekstet e minoriteteve...

Prania e teksteve si të tilla do na e riste shumë më shumë performancën e shkollës në sytë e komunitetit dhe nxënësve.

Dhe me të vërtetë, në vitin 2003-2004 pati një shtim të numrit të nxënësve, gjë që lidhet me politikën shtetërore për të rritur rolin e shkollave profesionale. Kështu nga 105 nxënës që regjistroheshin për çdo vit, kemi gati 2-fishin e numrit të nxënësve (204 nxënës për 2003-2004, 207 nxënës për 2004-2005, 200 nxënës për 2005 - 2006, 205 nxënës për 2006-2007, 184 nxënës për 2007 - 2008).

Gjithashtu zyra e sekretarisë, zyra e financës janë pajisur me kompjutera dhe është bërë trajnimi i tyre me financim nga PARSH. Në zyrën e financës punohet sipas programit kontabël Alfa. Kjo erdhi si rezultat i përfshirjes së drejtorisë së shkollës në projektin 'Coach' bashkëpunim gjermano-austriak për kompjuterizimin e sistemit administrativ.

Në vitin shkollor 2009-2010 fillon një fazë e re për arsimin profesional. Me vendim të MASH ndryshon struktura e shkollës në 2 + 2 dhe shkolla punon me kurrikula të reja në përshtatje me ndryshimet në sistemin arsimor dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Tani 2 vitet e para janë të Drejtimit "Ekonomi - Biznes" dhe në përfundim të saj nxënësit marrin një certifikatë të përgatitjes profesionale, pasi japin provimin "Formim teorik i integruar" dhe "Formim Praktik të integruar". Kurrikula është me dy nivele: Skeletkurrikula e hartuar nga AKAFP dhe e miratuar nga MASH dhe kurrikula në nivel shkolle ku programet hartohen nga grupet e punës me mësues të shkollës. Për herë të parë lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikës profesionale fillojnë që në vitin e parë të shkollës. Pas dy vitesh bëhet ndarja sipas kualifikimeve përkatëse psh: Ekonomist i mesëm banke, tatimesh etj.

Në katin e dytë të shkollës ka filluar të ndjehen nxënësit që do këmbëjnë klasat dhe laboratorët e mësimi dhe kjo zgjat pak, fare pak minuta për të kalur sërish në një gjendje qetësie relative mësimi dhe punë.

Në klasën e katërt B, një nga nxënësit i përkulur mbi



monitorin e kompjuterit është bërë i tëri njësh me të. Thua se nuk dëgjon dhe nuk e ka fare mendjen tek të papriturat që ndodhin në klasë. C'bëhet? Pyesim. Ai është duke bërë një blerje përmes interneti në një nga kompanitë më të mëdha Austriake dhe...

Si po bën një blerje.

Kjo është pjesë e lëndës dhe madje thotë Brisida, të gjitha veprimet e kryera janë qaq të prekshme dhe të rëndësishme saqë, vetëm paratë nuk lëvrohen realisht... Gjithçka që duket simuluese është një realitet mësimor tejet t pa zvendësueshem për ta dhe fort frytdhënës. Të gjithë të mbledhur kokë më kokë nga dy e nga tri sic dhe vihen re në fotot që ne fiksuam në klasën e tyre, janë të gatshëm të "vjedhin" gjithçka që lidhet me profesionin e ekonomistit.

Ne kemi edhe një vit shkollë ende sepse jemi me sistemin e vjetër të shkollimit,. Por kur na e do puna i futim hundët edhe tek pjesë të kurikulës së re të cilat ne nuk kemi pasur fat ti zhvillojmë.

Sigurisht kjo me ndihmën e pakursyer të mësuesve tona për të cilat ndjehemi krenarë.. thotë Brisaldi dhe i kthehet sërish kompjuterit.

Nuk ka sesi në dalje të mos kthehemi edhe tek biblioteka, e thjesht e vogël, por tejet funksionale. Një ekonomist mund ti lipset, sipas preferencave, fare mirë edhe letërsia...

Në oborrin e shkollës ku janë derdhur djem e vajza kush me një stik në dora a sanduic, shohim se ka syresh të përvjedhur ndanë shatrevanit, që e kanë ndezur nga një cigare "të merakosur e të thelluar ndër mendimet e tymit davaritës". Po këta, pyesim më shumë me sy e me nojma vajzat ekonomistet e ardhshme që na u ndodhën në krah.

Hic, nxënës të shkollës janë...

Dhe pinë duhan?..

Vajzat bënë buzën në gaz dhe si ndoqën me sy fjollat e tymit të cigares së pirë ditë më drekë dhe fare ashiqare, shtuan:

Jashtë mësimi, në oborr nuk ka pse ti ndalojë kush...

E ja këtë nuk e di as unë që shkruaj këto rradhet për to... A mund të pinë duhan qaq të krekosur përpara shkollës, në oborrin e saj...



Kur përkrahen përvojat në shkollë

Ndër punët më themelore, krahas mësimdhënies, artit të drejtimit, punës me dokumentacionin e veprimtarisë në shkollë është fakti se si u jepet krah përvojave. Përse? S'ka kurrësi mundësi që një shkollë të ketë mbarëvajtje nëse nuk njihen, nuk nxiten apo nuk vlerësohen përvojat. Në formë, duket diçka e thjeshtë, "e vogël", jo fort e rëndësishme, por në të vërtetë përbën një ndër shinat kryesore të ecjes përpara, të pasurimit të historikut të shkollës, të motivimit të gjithsecilit. Kur arrihet kjo? Sigurisht kur, radhë të parë, secili drejtues shkollë (drejtor, zv. drejtor, shef departamenti) ka koncepte të qarta lidhur me vlerat, me përvojat (kur jo vetëm konstaton, por mbi të gjitha shëmbëllen, ndihmon, organizon dhe evidencën e përgjithëson herë pas here përvojat në shkollë e jashtë saj. Çdo ditë e çdo javë, në çdo periudhë të vitit drejtuesi i mirë zbulon e nxit përvojat, kapet fort te vlerat në kolektiv, pa lënë në hije, si i thonë, edhe kritikën, me takt e durim, me argumente e në kohën e duhur, duke synuar gjithnjë tek e përparuar, te bashkëkohorja, te traditat e vjera dhe, mbi gjithçka, te reformimi i bazuar në kërkesa e kushte konkrete. Drejtuesit e shkollës patjetër duhet të luajnë rolin aktiv të "gjeologut", i cili me pasion, përkushtim e kujdes zbulon mineralet e çmuara. Edhe përvojat në kolektiv janë minerale të çmuara.

Duke vëzhguar kohët e fundit mjediset në shkollat 9-vjeçare "Kongresi i Manastirit2", "1 Qershori", "Murat Toptani", duke biseduar me mësues të pasionuar e nxënës veprimtarë, mësuam një dëshmi të thjeshtë e mjaft me vlerë: Në vijimësi u jepet krah përvojave. Mbetet vërtet për t'u marrë si model takti, vetëprimi, ndihmesa dhe roli reformues i drejtorëve të palodhur Mal Buçpapaj, Arben Beli e Lindita Aguridhi, i zëvendës drejtorëve veprimtarë Qani Çela, Ylli Dulja, Pranvera Pacari, Manjolla Allushi, rrezaton tek arritjet konkrete në rritjen e pasqyrimin e përvojave në mësimdhënie e veprimtari.

"Një shembull në praktikë më mirë se një mijë fjalë të bukura" - thoshte ideologu i madh i Rilindjes sonë Kombëtare, Sami Frashëri. Aty ku rrezaton shëmbëllimi, ndihmesa ndaj kolegëve e nxënësve, dashamirësia e përpjekja për të shtuar radhët e të përparuarve, aty u jepet krah përvojave.

Ia vlen të theksojmë në këtë shkrim përvojat mjaft me vlerë të konkurseve në shkollat "Murat Toptani" dhe "1 Qershori", kulturën e mjedisit dhe propagandën pedagogjike, stendat funksionale e gjithçka bashkëkohore në shkollën "Kongresi i Manastirit". Këto e plot përvoja të tjera nuk janë arritur lehtë, por si rrjedhojë e shëmbëllimit të drejtimit e rritjes së rolit të Qeverisë së Nxënësve, e vetëveprimit të departamenteve e përkushtimit të secilit mësues.

Në konkursin "Ne dhe demokracia në shkollë", në

Mevlud BUCI

Shkolla "Murat Toptani" Tiranë

shkollën "Murat Toptani" u përfshinë klasa e grupe veprimtarësh, u paraveprua, duke piketuar pyetje dhe duke hedhur në veprimtari konkrete nxënësit; pastaj, në fazën e tretë finale konkurruan klasat e 9ta ku u shpалosën edhe përvojat mësimore-edukative. Kështu u veprua edhe me konkurset "Ti vlen", "Krijuesit për pranverën dhe 5 Majin", për "Nënë Terezën nëna e paqes", për konkursin "Gurra e shpirtit popullor", ku për 8 muaj, në tri faza, u mblodh folklori i disa trevave nga vijënë nxënësit tanë.

Në veprimtarinë e mirorganizuar, krahas drejtuesve të shkollës kanë dhënë ndihmesë në vijimësi mësuesit Agim Xhelili, Fatime Çufaj, Rozeta Pollozhani, Ibrahim Mujollari, Enver Allmuça, Vesel Dalipi e plot të tjerë.

Shkolla është vatra ku bleron demokracia, ku bëhet edukimi i brezave, ndaj mbetet me rëndësi të madhe puna për t'u dhënë krah përvojave.

Ndryshimet në arsimin tonë demokratik janë të mëdha e të prekshme. Reformimi dhe edukimi kërkojnë çdo ditë shpirt krijues. Mësimdhënia efektive, përgatitja sa më e mirë për të ardhmen, për jetën, për shoqërinë tonë demokratike arrihet kur u jepet krah përvojave në shkollë e jashtë saj.





Nëpër shkollat shqipe, në Diasporë...

Në shkollat shqipe në Maqedoni

Nga Namik SELMANI

Unë nuk e di se si do të ishte ndjerë poeti ynë i madh kombëtar Naim Frashëri kur do të shihte veten në raftet e librit në atë shkollë që mban në ballinën e saj emrin e tij dhe një bust të mermeruar në një cep, pak afër portës kryesore, me të cilin përshëndeten çdo ditë fëmijët shqiptarë te qytetit të Kumanovës në Maqedoni. Kjo mëdyshje e bukur është edhe kurshehnjë pikurë shumë të madhe që ishte vendosur në korridorin kryesor të saj. Pasi na tregoi jo pa entuziazëm, për atë rrugë që ka bërë arsimit shqip në këtë qytet e në mbarë Maqedoni të paktën në 23 vitet e fundit, mësuesi i pasionuar, publicisti dhe veprimtari fort i dalluar për arsimin kombëtar Etem Xheladini, na vuri në duar një plumb të gjatë Gulinovi dhe një granatë krom të zezë. Kishim kohë që i kishim harruar kalibrat e plumbave dhe pamjet hijerënda të plumbave dhe jehonën e granatave që mund të binin një ditë mbi kokat e njerëzve. Vetëm rreth 10 vjet më parë të tjerë plumba, granata, por edhe topa godisnin shtëpitë, lulet, grunjërat e kullat Slupçanit e të fshatrave të tjerë. Granata e zezë krom dhe vetë plumbi i Gulinovit na rëndonin jo pak në duart, që posa kishin shfletuar një arkiv të jashtëzakonshëm të kësaj kujtese.

Çfarë kishte ndodhur? Në vitin shkollor 1987-1988 u mbyllën shkollat e mesme dhe tingujt e zileve shqip humbën krejtësisht. Me nismën e vetë Etem Xheladinit, drejtor i shkollës, u hap shkolla e parë shqipe. Në këtë betejë të vërtetë që mund të quhet kësaj radhe "beteja e shkronjave" kishte edhe shumë luftëtarë të tjerë. Kësaj radhe tingujt e zileve u bashkuan me vërshëllimat e kërbaçëve. Klasat që u hapën u quajtën nga shteti i kohës "Paralelet e egra". Mësimi bëhej me dashurinë e pakufishme për gjuhën shqipe,

por edhe me një terror të paparë mbi ta. Ishte mbi-jetesa kombëtare dhe identiteti kombëtar që duhej mbajtur gjallë. Vetë Idrizi dhe Etemi na kujtojnë me krenari dhe dhimbje këtë gjë. Na ndihmon me këto kujtime profesor Berati dhe profesori i matematikës Agim Rushiti që ligjëron edhe në Fakultetin Ekonomik të Kumanovës që është hapur me përpjekje të mëdha të mësuesve shqiptarë. "Kumanova e ka hapur shkollën e parë shqipe që më 1908 dhe këtë dashuri për shkronjën shqipe ajo e ka patur të gjallë në të gjithë vitet e këtij shekulli shumë më tepër se qytetet e tjera shqiptare në shteti maqedonas." "Paralelet e egra" si i kanë quajtur këtu klasat e hapura të

gjuhës shqipe, gjoja të jashtëligjshme, pa lejen e shtetit maqedonas në vitin 1991, ishin lajmëtarët e para të një arsimit shqip, pas shpërbërjes së Jugosllavisë. U desh edhe një grevë urie për të që nuk kishte qenë një praktikë deri në atë kohë në këto treva. Atëherë nxënësit dhe mësuesit e mbushur me entuziazëm, vishnin në trupa shumë e shumë rroba. Ishte një arsye e fortë që, po qe se

do t'i trajtonte keq policia, ata të ndjenin sa më pak dhimbjen trupore. Bashkë me një lloj kureshtjeje, për të mos thënë edhe habie ia kërkuam profesor Etemit "biografinë" e relikeve që edhe për shumë kohë s'mund të quhet veç kështu. Me vete kishim edhe profesor Zejadin Ismailin që është në këtë qytet kaq arsimdashës shumë më tepër se një arkiv i arsimit shqip. Njeri i zileve shkollore, por edhe i teksteve shqipe, i studimeve, të përfshira të paktë deri tani në 45 vëllime të botuara. Është një mësues veteran që të rrëmben me atë pasion që ka në rrëfim e viteve. E për mrekullinë e detajit që po na vinte vrullshëm, jo vetëm në kujtesë, por edhe në duar, në sy, në përfytyrim, profesori i moshuar na



"Kush nuk mëson gjuhën e vet, është i dënuar për jetë"

Babë Dudë Karbunara



kishte qenë për shumë e shumë vite edhe mësuesi i mësuesit Etem Xheladini. Aq sa do ta quaja edhe “Mësuesi i mësuesve shqiptarë”. Në sallën e vogël të informatikës ishte me ne edhe veprimtari tjetër Idriz Sinani që në ato vite kishte qenë krah për krah Etemit dhe shumë veprimtarëve të tjerë të arsimit shqiptar në Kumanovë e më gjerë. Të shtatë fëmijët e tij, gjithashtu kishin pas qenë ish nxënësit e Profesor Zejadinit. Një klasë e vërtetë që rridhte nga një familje e vetme. Rastësia shumë e bukur që pamë pas pak orësh na krenoi edhe më. Gazetari, poeti zëllirik e miku im Sevdail Demiri që sot është bërë një zë i fuqishëm në gazetarinë shqiptare të Shkupit, por edhe në atë televizive, kishte qenë ish nxënësi i vetë profesor Etemit. Nuk ishte vetëm kjo traditë brezash një lloj nostalgjie, por edhe një ringjallje e vetë poetit, Naim Frashëri. Edhe pa shkelur në këto troje gjaku e ëndrrash, Naim Frashëri do të kishte pasë qenë fort i lumturuar në ringjalljen e tij. Në muret e sallës që dukej shumë shumë e vogël për tërë atë rrugë, shikonim fotografi të hapjes së Universitetit të Kumanovës në degën ekonomike, ku sërish Etemi na kishte qenë nismëtari i parë i tij. Duket se Naim Frashëri po ringjallej, bash edhe në Tetovë, disa dhjetëra kilometra larg nga ky qytet. Do të ishte dalta e skulptorit gjakovar Asim Lokaj dhe e vëllait të tij, Xhevitit, që do ta jetësonin atë jo thjesht në një bust, por në një Monument të vërtetë mbi tre metra të lartë.

E, nëse dikur Petroninët hapnin shkolla ku mund të mësohej vetëm abetarja, në ato vite po bëhej shumë më tepër.

...Ndaj profesor Etemi sërish nuk e fshehu në ndonjë dollap apo në sirtarët e regjistrave dhe të dokumenteve arkivorë të tij atë plumb dhe granatën, por i la sërish në vitrinat e atij muzeu të vogël që kishte krijuar e që jo shumë kohë më vonë mund të ishte një pjesë e re e Muzeut Kombëtar të Arsimit Shqip. Jo, këta njerëz të urtë që e kishin lidhur të tërë jetën me zile, me urime nënash, me buzëqeshje fëmijësh që marrin diturinë e kombit të tyre, nuk donin që

të bëheshin vrasës. Por plumbi dhe granata ishte vetë historia e shkollës shqipe. Ishte një e vërtetë, para së cilës nuk mund të heshtje. Pak minuta më vonë në një ekran të trëndafiltë kompjuteri po lexoja mjaft shkrime të mësues Etemit për atë gjendje akoma jo të mirë që ka arsimit shqip ende në Maqedoni për shumë nevoja që ka një shkollë evropiane që kërkon identitet e të ardhme. Ai prej disa vitesh është njëkohësisht edhe kryetar i Lidhjes së Arsimtarëve Shqiptarë të Kumanovës gjithashtu edhe mësimdhënës në shkollën fillore shqipe “Naim Frashëri” që ka aktualisht 1300 nxënës shqiptarë. Vazhdon të shkruajë me shumë kuraje në gazeta të ndryshme dhe të flasë në televizione në mbrojtje të të drejtave të mësuesve dhe nxënësve shqiptarë.

Ndërkohë që me dhjetëra lexues, prindër, nxënës e falënderojnë për këtë ndihmesë që ai bën. Kështu në një shkrim të botuar më 17 maj 2010 ai shkruan ndër të tjera: “1300 nxënës shqiptarë me 54 paralele, sot për sot, kanë mungesë kabinetesh e kushtesh të tjera, në një kohë që shkolla fillore “Vuk Karaxhixh” me 325 nxënës serbë e maqedonas ka të njëjtën hapësirë, edhe pse ka katër herë më pak nxënës dhe vetëm 18 paralele”

...Kur u larguam nga shkolla, zilet sërish tringëllinë. Një tringëllimë shqip. Na u duk një mirëseardhje e ngrohtë më shumë se ai “bujrum shqiptarisht” që e pamë në vatrat e këtij qyteti. Një zile të tillë po e dëgjoja çdo ditë edhe në Berat, edhe në Tiranë. Një zile që s’duhet të heshtë kurrë. Sytë e ndritshëm dhe lëvizjet energjike të mësues Etemit, urtia e profesor Zejadinit, të shprehur në ato dhjetëra vepra, të Idrizit aq të njohur për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve, shkrimet aq të pjekura dhe kurajoze në mbrojtje të kulturës shqiptare të Sevdailit, po ma bënin edhe më ëmbëltoje atë zile, me të cilën edhe unë kam lidhur jetën



time. Po përkujtonim së bashku 110-vjetorin e vdekjes së Poetit tonë të madh. Në këtë emocion kaq të madh po ringjallej vetë Poeti. Njëlile tingullshqipe që përherë zgjon poetë e mësues. Mësues e prindër, pushtetarë dhe intelektualë. Që zgjon sa e sa energji të vetvetes për të ecur sa më shpejt në këtë rrugë. E tek largohesha me këto emocione m’u kujtua shprehja lapidar e Babë Dudë Karbunarës: **“Kush nuk mëson gjuhën e vet, është i dënuar për jete”**

Ju pyesni, ne përgjigjemi

Në redaksinë e revistës “Mësuesi” kanë ardhur shumë letra në të cilat shumë mësues, pedagogë dhe specialistë të arsimit duan të dinë se cilat janë kriteret e daljes në pension.

Të dhëna për përfitim të pensioneve të Personelit Akademik

Fadil KEPI, specialist për problemet sociale.

(vijon nga numri i kaluar)

Sipas ligjit nr.9786, datë 19.7.2007, botuar në fletoren zyrtare nr.68, personeli akademik me titullin profesor shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç femra dhe meshkuj, me përjashtim të rastit, kur me kërkesën e tij ose të saj lirohet nga detyra për arsye të plotësimit të moshës së pensionit, sipas ligjit të sigurimeve shoqërore.

Konformë ligjit nr.10139, datë 15.5.2009, botuar në fletoren zyrtare nr.87, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të Universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjithë Institucioneve të tjera kërkimore Publike”, të cilët kanë grada shkencore Profesor, Profesor i Asociuar, Drejtues Kërkimesh, Mjeshtër Kërkimesh, i cili ka hyrë në fuqi nga data 1 janar 2010, përfitojnë : pension suplementar 1,3 Profesorët dhe drejtuesit e Kërkimeve dhe 1,1 për qind të pagës referuese Profesorët e Asociuar dhe Mjeshtër të Kërkimeve të pagës referuese për cdo periudhë njëvjeçare.

Sipas nenit 7 të ligjit të mësipërm, shumica e pensionit suplementar bashkë me pensionin e zakonshëm nuk mund të jetë më e madhe se katër pensione bazë.

Në bazë të neneve 31 dhe 33 të ligjit të sigurimeve shoqërore Nr.7703, datë 11.5.1993, me plotësimin e kushteve të mësipërme për pension, qendrës së punës dhe të interesuarve u lind e drejta për pension, por në rastet kur shkolla apo fakulteti kanë nevojë të ngutëshme është në kompetencën e tyre, që duke marrë dhe mendimin e atij apo asaj, që ka plotësuar kushtet për pension, ta mbajë në punë për aq kohë sa bien dakort, duke nënshkruar një kontratë provizore konform nenit 140 të Kodit të Punës.

Sipas Kodit të Punës, punëdhënësi nuk mund të zgjidhë kontratën e punës kur punëmarrësi është me leje të zakonshme, leje lindje, me shërbim brenda e jashtë vëndit, apo me raporte mjeksore.

Personat që plotësojnë kushtet për pension, marrëdhëniet financiare të punës i ndërpresin, mbasi marrin edhe lejen e zakonshme, mbështetur në nenin 92 të Kodit të Punës dhe vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, e cila jepet në përpjestim me kohën e punës. Për shembull, një mësues plotëson kushtet për pension më 30 prill të vitit 2011, meqënëse ai ka punuar një të tretën e vitit kalendarik i takon dhe një e treta e lejes se zakonëshme.

Leja e zakonëshme mësuesve dhe pedagogëve u jepet dhe paguhet si vit kalendarik për kohën që kanë punuar nga 1 janari deri me 31 dhjetor të cdo viti dhe jo si vit shkollor.

Konform vendimit të Këshillit të Ministrave nr.369, datë 13.06.2007, “Për fondin e veçantë në institucionet buxhetore”, botuar në fletoren zyrtare nr.83, faqe 427, dhe Udhëzimit përkatës të Ministrisë të Financave, botuar në fletoren zyrtare 128, punonjësve që kanë punuar në institucionet buxhetore kur dalin në pension u jepet shtesë një pagë mujore.

Ata dhe ato që dalin në pension, duhet të dorëzojnë me procesverbal të gjitha vlerat materiale që kanë në ngarkim, si kompjutera, paisje laboratorit, zyre, si dhe të shlyejnë të gjitha detyrimet financiare nëse kanë si dieta, paradhënie, etj. Pa kryer këto veprime, drejtuesi dhe dega e financës e qendrës së punës nuk i jep asnjë dokument, që nevojitet për efekte të daljes në pension.

Sipas Rregullores nr.1 datë 20 tetor të vitit 2008 të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, dokumentat e pensionit mund të përgatiten dhe të dorëzohen në agjencinë e sigurimeve shoqërore deri 12 muaj kalendarik para

plotësimit të kushteve për pension.

Mbështetur në nenin 62 të ligjit të sigurimeve shoqërore, e drejta për pension nuk parashkruhet. Kur dokumentat paraqiten në agjencinë e sigurimeve shoqërore brenda 365 ditëve kalendarike, nga dita e lindjes të së drejtës për pension dhe ndërprerjes së marrëdhënieve financiare me qendrën e punës, pensioni merret për gjithë periudhën e kaluar. Në rastet kur dokumentat paraqiten në organet e sigurimeve shoqërore mbas 365 ditëve kalendarike pavarësisht nga arësyet, pensioni fillon e paguhet nga dita e dorëzimit dhe regjistrimit të dokumentave në agjencinë e sigurimeve shoqërore, duke humbur të drejtën e marrjes së pensionit për periudhat e shkuara.

Pensionistët përfitojnë falas barnat mjeksore të rimburoshme sipas listës së miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe nuk paguajnë as 100 lekë të vleftës së recetes mjeksore, duke paraqitur në farmaci përveç recetës mjeksore dhe librezën e pensionit.

Pensionet e posacme dhe ato suplementare nuk trashëgohen.

Pensionet e marra tepër, kthehen duke u mbajtur çdo muaj pensionistit 20 deri në 50 për qind të pensionit mujor, konformë ligjit nr.9377, datë 21.4.2005, botuar në fletoren zyrtare nr.37 të atij viti.

Dokumentet që duhen përgatitur për të dalë në pension janë:

-Libreza e punës e plotësuar deri ditën e fundit, që është paguar me rrogë.

-Libreza ushtarake për meshkujt që kanë kryer shërbimin e detyrueshem ushtarak.

-Çertifikatë personale me fotografi certifikatë e gjendjes familjare dhe certifikatë martesë vetëm për femrat.

-Vërtetim i pagës nga 1 janari i vitit 1994, deri ditën e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare. Këto janë vërtetime standarte dhe punonjësit e financës janë të specializuar për plotësimin e tyre.

-Kopja e noterizuar e diplomes të shkollës së lartë ditën për femrat.

-Kërkesa për pension, që është një formular i gatshëm që merret në qendrën e fundit të punës, ku shënohet edhe adresa e banimit, numri i telefonit, etj.

Koha e caktimit të pensionit nga organet e sigurimeve shoqërore zgjat 60 ditë kalendarike, prandaj rekomandohet që dokumentat të plotësohen sa më shpejt. Nëse nuk ka mundësi të paraqitet vetë personi për plotësimin e dorzimit e dokumentave pranë sigurimeve shoqërore, mund të autorizoj një person tjetër.

Personit që në të njejtën kohë i takon më shumë se një lloj pensioni (si pension pleqërie, familjar apo pension invaliditeti) ka të drejtë të zgjedhë njerin prej tyre me shumë më të lartë.

Pensionisti kur ndërron vendin e banimit ka të drejtë të kërkojë edhe transferimin e pensionit pranë vendbanimit të ri.

Me qëllim që të mos ketë keqkuptime për nxjerrjen në pension të punonjësve, drejtuesve të institucioneve arsimore duhet që të njihen më mirë me dokumentat e punonjësve që kanë plotësuar kushtet për pension. Problemet e paqarta të sqarohen me organet e sigurimeve shoqërore pastaj t'i njoftojnë të paktën tre muaj përpara punonjësit e tyre që do të nxjerrin në pension, siç përcaktohet në Kodin e Punës dhe t'i bindin ata për legjisllacionin e pensioneve.

Në rastet kur pensionistët nuk binden me masën e pensionit të caktuar, në baze të nenit 86 të ligjit të sigurimeve shoqërore kanë të drejtë të ankohen me shkrim fillimisht pranë komisioneve të ankimit pranë drejtorisë rajonale të sigurimeve shoqërore, Institutin e sigurimeve shoqërore dhe se fundi në gjykatë, vendimi i së cilës është i formës së prerë.

Shkolla jonë dhe projekti “Të njohim Europën”

Europa dhe qytetërimi perëndimor na e kanë bërë tashmë ftesën për të hyrë në gjirin e tyre. E gjithë fuqia institucionale e shtetit shqiptar është përqendruar tek integrimi, madje ky do të jetë fokusi edhe për shumë vite të ardhshme. Mirëpo, përtej marrëveshjeve dhe kushteve politike apo ekonomike, para së gjithash, kjo do të thotë “thëthitje” e ajrit të mendimit dhe kulturës së qytetërimin të saj; do të thotë njohje, “përvetësim” dhe “bashkim” dinjitoz me atë korpus gjigand kulture, dijesh e veprash, me anë të të cilit brezat e tërë të mendimtarëve, heronjve, shkencëtarëve, artistëve dhe njerëzve të shquar evropianë ngritën shtatoren e një botëkuptimi të lirë dhe mbujtën formën e një zemre të hapur e të kultivuar. Rruga është e gjatë, shumë më e vështirë dhe komplekse se integrimi institucional; ndaj që kjo ndërmarrje të mos na kthehet në një gur Sizifi, por në një çlirim shpirtëror, në një proces emancipimi, na lipset patjetër një bazë ku të mbështetemi. Vullneti dhe pasioni mund të shërbejnë si një pikënisje e volitshme, por përsëri na lipset patjetër një dorë ndihme. Një dorë ndihme që natyrshëm, ashtu siç në çdo gjë të re që mendohet të mbillet, për t’u rritur më pas e shëndetshme, duhet t’u jepet pikësëpari fëmijëve tanë e duhet të fillojë menjëherë nga shkolla jonë.

Po ku konsiston vallë një ndihmë e tillë?

Të gjitha vendet e reja që iu bashkëngjiten së fundmi Bashkimit European, por edhe vendet me histori të gjatë në të (për të marrë një shembull konkret, edhe fqinjët tanë, Italia dhe Greqia), duke synuar ta përshtatin kulturën e mësimit dhe edukimit nëpër shkollat e tyre me këtë perspektivë të përbashkët që i pret gjithë kombet e kontinentit tonë, ideuan dhe implementuan një program të posaçëm, të shumëformshëm dhe afatgjatë, me titull “Të njohim Evropën”. Nivelet e informacionit qenë të shtrira, por përqendrimi kryesor ishte ai i botimit të librave me përmbajtje të posaçme, pra të përshtatur për fëmijët e ciklit të arsimit bazë, por edhe ata të arsimit të mesëm dhe ndërfutja e tyre në programin mësimor. Pse vallë, nuk do të që mënyra më e mirë e edukimit dhe perspektivës së fëmijëve tanë dhe të shkollës sonë implementimi edhe në shoqërinë shqiptare i këtij programi? A s’do të që një kulturë-formim i dobishëm, i nevojshëm dhe dinjitoz për kohën që po kalojmë, njohja e brezit tonë të ri dhe fëmijëve tanë me historinë e Evropës, me fazat e kalimit të saj që nga grekët e romakët në Mesjetë, Rilindje dhe deri në kohët moderne?

Po njëllor e dobishme do të që edhe njohja e veçantë dhe e përmbledhur e historisë së disa prej kombeve më të shquar të saj (Angli, Gjermani, France, Spanje, etj). Duke njohur heronjtë (bie fjala heronjtë legjendare të kombeve më të mëdhenj të Europës si: Zigfridi - nordik, Rolandi - francez, Sidi - spanjoll, Bewulfi - anglosakson, e kështu me radhë), njerëzit e famshëm të kësaj historie, të sistemuara në një seri të veçantë si “Krijuesit e historisë” (të tillë si Romuli, Jul Qezari, Aleksandri, Mbretëresha Elizabet, Alfredi i madh, Uilliam Pushtuesi, Zhan D’Arka, Pjetri i madh, Napoleoni, etj), bëmat dhe përpjekjet e tyre në marshimin e gjatë që e nxori racën njerëzore prej skllavërisë së Mesjetës, në kohët e zhvillimit ekonomik dhe kulturor, duke njohur, pra, këtë marshim dhe histori të lirisë së Evropës, mohet dhe vlerësohet akoma dhe më mirë liria ku sot jetojmë, rrënjoset e brumoset akoma dhe më mirë tek fëmijët tanë edukimi demokratik dhe shoqëror për të cilin kemi aq shumë nevojë. E më tej, nëse krahas miteve, legjendave dhe heronjve tanë më popullorë, krahas eposit tonë, fëmijët tanë mësojnë edhe mitet e legjendat e antikitetit greko-romak apo të Europës veriore, heronjtë dhe njerezit e shquar të mesjetës dhe kohëve moderne të Europës

(të përmbledhur në antologji biografike të formes “Luftëtarë dhe eksploratorë”, “Mendimtarë dhe burra-shteti”, “Barbarë dhe fisnike”, “Patriotë dhe tiranë”, “Artistë dhe autorë” etj), eposet dhe sagat legjendare të kombeve të mëdhenj evropianë (si p.sh. “Eposi i Nibelungëve”, “Këngët e Rolandit, Poema e Sidit, Sampo (eposi nordik, etj), bashkë me përmbledhje të përzgjedhura vëllimore të baladave, romancave, epikave dhe rrëfimeve popullore të kombeve të Evropës, të nxjerra nga ato më të spikaturat dhe kombëtare, a nuk do të shfaqen ata vallë më me dije, kulturë e formim, nesër kur të jenë pjesë organike e këtij qytetërimi? Po kështu dobi-prurës në këtë drejtim, do të që edhe njohja e artistëve të artit të vjetër e modern evropian, me kompozitorët e saj të mëdhenj, me historinë e zbulimeve të mëdha gjeografike që ajo kreu në Mesjetë dhe me figurat e mëdha të eksploratorëve që ajo i dhuroi botës (Kolombi, Magelani, De Gama, Vespuçi, Kortezi, De soto, Balboa, Leon). Po nëse njihen në mënyrë të orientuar e të përmbledhur me Klasikët e letërsisë së antikitetit (si p.sh. Herodoti, Tuqididi, Aristofani, Homeri, apo me romakët si Plutarku, Ovidi, Tit livi, Virgjili etj, nëse njihet në mënyrë të përmbledhur me tragjedianët, apo komedianët grekë, me dramatikët e veprave më të shquara të Mesjetës, si ato të Dantes, Shepksirit, tregimet e Kantërburit, Pentameronin, Kalorësit e Mbretit Artur, apo Tristani dhe Izolta), a nuk do të jenë vallë po kaq dinjitozë e të formuar më vonë kur të preken e të qasen me realitetet kulturore dhe historike të këtyre vendeve? Po nëse njihen me shkencëtarët dhe shpikjet e tyre të mëdha gjatë gjithë historisë, që prej antikitetit, me njerëzit e mençur dhe dijen e tyre të filozofisë dhe sociologjisë, a nuk do të jenë më të përgatitur e më të gatshëm për t’u përballur me kërkesat e kohës në tregun e punës?

Ky program duhet të fillojë menjëherë, duke përzgjedhur dhe bërë të gatshme këtë literaturë nëpër shkollat dhe bibliotekat tona, gërshtuar me përpjekjen kurrikulare të saj. E kanë bërë shumica e vendeve që sapo i janë bashkuar BE, literatura e kurrikulave më të mira të BE dhe perëndimit është aty për të na ndihmuar në këtë nismë. Tashmë pritët vetëm vullneti për ta zbatuar atë. Por rëndësia e tij më e madhe është se i jep një impuls dhe kanalizim të jashtëzakonshëm asaj që përbën dobësinë më të madhe të shkollës sonë: aftësisë edukuese. Është ky program konkret, i strukturuar në seri dhe literaturë të përzgjedhur për çdo lëndë, që do t’i japë mundësi shkollës sonë të bëjë hopin e madh, të kalojë nga mësim-dhënia tek edukimi.

Së dyti, ky program është thelbësor dhe si i tillë duhej t’i paraprinte ndryshimeve strukturore. Evropa, në të gjithë ambientin tonë shoqëror, sot është kthyer në një fjalë të magjishme. Me kuptimin dhe besimin kundrejt këtij qytetërimi, duket se po lidhet çdo lëvizje shoqërore, ekonomike, politike dhe jetësore. Është për t’u vlerësuar dhe konsideruar si armë strategjike në duart tona ky entuziazëm optimist, që me një program të tillë do të arrijë kulme, pasi ai na jep shumë epërsi në raport me shumë shtete dhe kombe të tjera përreth nesh, që aktualisht janë bërë edhe pjesë integruese e Evropës, apo vende të tjera që janë në garë e aspirojnë të bëhen pjesë ekonomike, politike dhe administrative e këtij bashkimi. Por nga ana tjetër, përfitimet do të jenë edhe nga ana gjeopolitike, pasi një nismë e tillë do të ketë jo vetëm jehonë por do të tregojë se integrimin në e shohim si një proces strukturor dhe kulturë-formues të gjithë indit tonë shoqëror, gjë që hedh baza më të forta dhe të sigurta për të ardhmen dhe shpreh një vizion largpamës dhe tërësor.

Shtrëngimit i dorës dhe sfumaturat e kuptimit (vëzhgime dhe studime)

Dhënia e dorës është një gjest i thjeshtë, veç të njohësh ekuacionin e duhur, pasi zbulon shumë aspekte të personalitetit tonë. Por si jepet dora në mënyrën më të drejtë? Kjo shpjegohet nga një studiues anglez me një formulë matematikore.

Disa vite më parë, i joshur nga diplomacia dhe takimet e liderëve botërore, por edhe në nivele më të ulta, ndiqja me vëmendje dhe lexoja me kërkësi studimet që lidheshin me këtë fenomen që pavarësisht në dukje diçka e zakonshme, fshihte në vetvete karaktere dhe personalitete të ndryshme të njeriut. Nëse do të shfletojmë Galateon, do të gjejmë aty plot njohuri të dobishme për bontonin në jetën e përditshme, por edhe për shtrëngimin e duhur të dorës në mjediset e pritjeve aristokrate dhe borgjeze. Tek të parat nëse nuk je në unison me mjedisin rrezikon të mbetesh në gojën e thashethemeve të oborreve për edukimin e mangët që ke marrë, tek të dytët, ndoshta jo gjithmonë, ky edukim mund të duket anormal. Kur bëhet fjalë për takime diplomatike, sigurisht edukata dhe mënyrat e sjelljes kanë një rëndësi të madhe, pasi aty nuk përfaqëson vetëm vetveten, por edhe shtetin. Nuk besoj se ka ndonjë lider të pagabueshëm, por gafat që po i quajmë protokollare dhe diplomatike ekzistojnë në arkivat e shkollave që përgatitin diplomatët e ardhshëm dhe, këtu nuk po përmend diplomacinë shqiptare, pasi shpesh gafat janë botuar në faqet e shtypit të përditshëm. Në profesionin tonë të përditshëm nëpër auditorë ke mundësi të studiosh të gjitha sfumaturat që shtrëngimi i dorës të jep: që nga ai i përshëndetjes së përditshme me studentë e kolegë e deri tek të njohurit që mund të takosh në mjediset e universitetit, apo jashtë tij, pa përmendur takimet me miq apo shokë, me të cilët relatat janë krejt të ndryshme dhe studimi i mënyrave të sjelljes del jashtë kornizave "të etikës" së ngurtë.

Vite më parë, kur punoja në shkollën e gjuhëve të huaja, në Korçë, një shtrëngim dore në çastin e hyrjes së nxënësit në provim, kishte vlera të vërteta njerëzore, qetësie, sigurie se nuk do të penalizohej me notë negative, pasi ka nxënës që emocionalisht janë tepër të ndjeshëm dhe largësia apo ftohtësia me rrezikon e "familjarizimit", mund ta blloktojë. Gjithsesi, në shkolla jemi larg atyre takimeve zyrtare që përmendëm pak më lart, por që një shtrëngim, apo një përplasje dore transmeton edhe shumë gjëra të tjera të cilat luajnë një rol të rëndësishëm psikologjik tek të rinjtë, sidomos në këto vite tepër të vështira shqiptare, ku për motive banale, po i shohim përditë në ekrane dhe gazeta, të rinjtë arrijnë të mosvetëpërmbahen, duke shkaktuar probleme të rënda ndaj jetës së bashkëmoshatarit. Por vrojtimit shkojnë edhe më tej, në takimet zyrtare me të huajt që kemi pasur rastin të takojmë, por dhe me shqiptarë, të lexueshme në shprehjet e ndryshme që merrnin fytyrat, pasi shtrëngimit të parë të duarve. Fondi është tepër i pasur me gafa dhe mënyra sjelljesh në to: që nga përqaftimi, takimi edhe me një rrahje të lehtë të shpatullave, apo kohëzgjatje shtrëngimesh pambarim, batuta me vend e pavend therëse ndaj bashkëbiseduesit etj. Në auditorët e universitetit, studimet dhe vrojtimit mund të ndahen në dy momente: pedagog - student dhe student - student. Tek grupi i dytë sot është më modë përplasja e dorës, qepalla, pasi studentët synojnë të tregojnë solidaritetet mes tyre, afri, se janë të një mendje. Shihet me dyshim dikush, nëse nuk ndjek ritin e mësipërm. Edhe shprehjet e fytyrës ndryshojnë si për të thënë se diçka nuk shkon. Tek grupi i parë mund të shohësh që nga ai më zyrtari e deri tek përplasja, të cilën e përdor edhe vetë personalisht si formë përshëndetje, për të treguar se jemi aty nëse dëshirojmë të bisedojmë për problemet e shumta me të cilët studentët ndeshen. E probleme ka dhe ka ca si shumë për moshën e tyre.

Secili prej nesh gjatë jetës na takon ta bëjmë 15 mijë herë dhe në 70% të rasteve lindin dyshime: A po e jap në mënyrën e duhur? Po nëse atij apo asaj nuk do t'i pëlqejë? Cila është përshtypja që do të krijojë për mua?

Po flasim për një shtrëngim dore, vulë e traktateve të paqes,

Arjan. Th. KALLÇO Universiteti Fan S. Noli, Korçë

miqësisë së përrjetshme dhe të bizneseve pak a shumë të rëndësishme. Sipas studiuesve 20 % e njerëzve e urren shtrëngimin e dorës me të tjerët dhe kjo i shtyn ta bëjnë në mënyrë të sforcuar dhe të pakëndshme: pëllëmbë të djersira, shtrëngime të rrëshqitshme si ngjalat, apo të zhurmshme kërcitëse, janë gabimet më të zakonshme që në takimin e parë, mund të prishin imazhin që i transmetohet bashkëbiseduesit. Ka edhe raste ekstreme të ndonjë aktori hollivudian, i mirënjohuri Edi Marfi, që e ka fobi higjenike shtrëngimin e dorës me të tjerët.

Shtrëngimi i dorës në vende të ndryshme ka edhe kuptimet simbolike të veta, si në Greqi, që për mirësjellje të japin dorën e majtë, atë të zemrës, apo në vendet aziatike që përshëndetja bëhet vetëm me një përkulje, pa nevojën e domosdoshme të shtrëngimit.

Geoffrey Beattie, përgjegjës i Shkencave Psikologjike të Universitetit të Mançesterit, përpunoi një formulë të shtrëngimit perfekt të dorës e cila jepet në ekuacionin e mëposhtëm, me gjithë shpjegimet e simboleve në të. E këtu, do të duhet puna e kolegëve tanë të matematikës që studimi të jetë më i plotë dhe për ta çuar drejt tipologjizimit të karakterit shqiptar të shtrëngimit të duarve.

$$PH = \sqrt{(e^2 + ve^2)(d^2) + (cg + dr)^2 + \prod \{(4s2)(4p2)\}^2 + (vi + t + te)^2 + \{(4c2)(4du2)\}^2}$$

- (e) - kontakti pamor
- (ve) - qasja me bisedë
- (d) - buzëqeshja e Duchenne-me sy dhe gojën në mënyrë simetrike
- (cg) - plotësia e shtrëngimit
- (dr) - shtrëngim i thatë i dorës
- (s) - mat forcën e shtrëngimit
- (p) - pozicioni i dorës
- (vi) - tregon fuqinë
- (t) - temperatura e dorës
- (te) - tregon kompaktësinë e dorës
- (c) - tregon kontrollin e gjestit
- (du) - kohëzgjatja e shtrëngimit

Pra nëse i jepni dorën dikujt dhe shihni në tokë, duke thënë gjëra pa sens dhe keni dorën e ftohtë, të butë dhe të lagur, vështirë se mund t'i transmetoni bashkëbiseduesit tuaj një përshtypje të mirë. Shtrëngimi i dorës është një nga elementët e rëndësishëm në raportet ndërpersonale dhe në formimin e përshtypjeve të para për dikë. Zbulon menjëherë aspekte të rëndësishme mbi personalitetin e atij që kemi përballë: nëse është tepër e butë tregon pasiguri, ndërsa një shtrëngim shumë i shkurtër mund të tregojë arrogancë - pohon studiuesi.

Si është një shtrëngim perfekt i dorës?

Rregullat janë të njëjta për burrat dhe gratë: i zgjatet dora e djathtë, me një shtrëngim të fortë, por jo të tepërt, në një pikë në gjysmën e rrugës midis nesh dhe atij që kemi përballë. Pëllëmba duhet të jetë e thatë dhe e freskët dhe duart duhet të tunden 3 herë për një kohë jo më të gjatë se 2-3 sekonda. Duhet ta shikojmë në sy, duke i buzëqeshur në mënyrë spontane dhe me një formë përshëndetje apo prezantimi të unison me situatën.

Besoj se këto nuk janë gjëra të rëndomta, nëse do të shohim se tek ne nuk praktikohet shumë ideja e shtrëngimit të dorës nga ana e operatorit që servir një shërbim të caktuar, bilë në mjediset të ndryshme mund të vrojtosh edhe fenomene të tjera që lidhen me marrëdhëniet delikate mes partnerësh.

Drejtuesit e Chevrolet-it kanë organizuar një kurs për shtrëngimin e dorës në programin formues të arritjeve të tyre në shitjen e makinave në tregje dhe financuan studimin e Beattie. Shtrëngimi i dorës nuk është vetëm një përshëndetje rituale, por edhe një mënyrë për të konkluduar në një biznes. Sipas drejtuesve është e rëndësishme që stafi ynë është në gjendje ta bëjë në mënyrën më të mirë për të transmetuar besim dhe siguri tek klientët.

FOTO KONKURSI



Duke festuar në ditën e Liberalizimit të vizave...

Si mund të kontaktoni me ne:



Nina Gjoçi:
ngjoci@mash.gov.al;
tel. 04 222 5859



Vjollca Spaho:
vspaho@mash.gov.al;
cel. 069 5376532



Andon Andoni:
aandoni@mash.gov.al;
cel. 069 4439598



Adresa e redaksisë: Rruga e Durrësit (pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës), nr. 23 - Tiranë
tel. 04 2227206 - revistamesuesi@mash.gov.al

U shtyp në shtypshkronjën "ALBDESIGN" - Autostrada Tiranë-Durrës km. 5 - www.alb-design.net